



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 265 Akti

Nr. 323 Vendimi
Tiranë, më 10.12.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici

Firdes Shuli

Brunilda Bekteshi

Kryesues

Relator

Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datat 7.12.2020 dhe 10.12.2020, në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, salla 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Albert Demirneli**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Demirneli, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Albert Demirneli, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Z. Albert Demirneli, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.1.2019, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Brunilda Bektashi dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.
4. Me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 9.10.2018, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demirneli.
5. Me shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 17.12.2019, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Demirneli, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. *** datë 12.12.2019, të KDZH-së.
6. Me shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 8.9.2020, KLP-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demirneli.
7. Me vendimin nr. 1, datë 24.1.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Albert Demirneli, duke u bazuar në të tri kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
8. Në datën 21.2.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije dhe e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti nuk u shpreh mbi gjendje konflikti interesi me ndonjë prej anëtarëve të trupit gjykues.
9. Me vendimin nr. 2, datë 18.11.2020, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Demirneli, dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit, të bazohet në tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimin profesional, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.
10. Në datën 20.11.2020 përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 30.11.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Në datën 30.11.2020, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, dërgoi shpjegimet dhe provat e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

12. Trupi gjyqës, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, njoftoi subjektin me anë të postës elektronike mbi zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 7.10.2020.

13. Në datën 7.10.2020, u zhvillua seanca degjimore, në përfundim të së cilës, subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi ***, dhe ka dorëzuar deklaratat e interesave private (në vijim DPV), ndër vite, për periudhën 2003 – 2017, dhe deklaratën *Vetting*.

ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera par subjektin Albert Demirneli, ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar Vendimit Nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Demirneli, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke kryer kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurine e subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demirneli, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të

rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ sipas neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si vijojnë:

1. Bashkëpronar në apartament banimi me sip. 68 m², ndodhur në lagjen “****”, Burrel, z. k. ****, nr. pasurie ****, për të cilën subjekti ka deklaruar :

“ *Kjo pronë është në pronësi të I. D. (babai), H. D. (nëna), Albert Demirneli, A. D. (vëllai), V. D. (motra), Sh. D. (motra) është përfituar nga kontrata për privatizimin e banesës, datë 23.08.1993. Vlera: 13 425 lekë (trembedhjetë mijë e katerqind e njëzetepesë) lekë. Pjesa në % 1/6.*

- *Nga kjo pronë është hequr dorë “de facto” që në vitin 1993 dhe “de jure” në datën 23.3.2016. Kjo mund të vërtetohet nga deklaratat noteriale nr. **** rep., nr. **** kol., datë 23.3.2016, nga certifikata e pronësisë dhe kartela e rifreskuar e pasurisë lëshuar në datën 1.4.2016”.*

Pavarësisht se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, në referencë të nenit 3/11 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcës nr. 2 “*Deklarata e Pasurisë*” të tij, subjekti nuk ka pasur detyrimin për ta deklaruar atë, pasi në momentin e plotësimit të kësaj deklarate, nuk e ka pasur bashkëpronësinë mbi këtë pasuri, fakt i konfirmuar edhe nga informacionet e vëna në dispozicion nga ZVRPP-ja Mat¹.

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se deklaratimet e subjektit në lidhje me këtë pasuri, vërtetohen tërësisht me dokumentet e vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja², sipas të cilave: (i) babai i subjektit të rivlerësimit, z. I. D., ka përfituar pasurinë e llojit apartament me sip. 68 m² në Burrel, me kontratë për privatizimin e banesës të datës 23.8.1993; (ii) pasuria nr. ****, është regjistruar në emër të 6 anëtarëve të familjes Demirneli, sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 14.2.2003, nga ZVRPP-ja Mat; (iii) me deklaratën noteriale nr. **** rep., nr. **** kol., datë 23.3.2016, deklaruesi Albert Demirneli ka hequr dorë nga e drejta e bashkëpronësisë në 1/6 pjesë të pandarë mbi pasurinë nr. ****, në favor të vëllait të tij, z. A. D.

Duke qenë se në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003, subjekti nuk e ka deklaruar 1/6 pjesë të pandarë mbi pronësinë në këtë apartament banimi, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit iu kërkuan sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Në parashtrimet e tij të datës 30.11.2020, z. A. D., deklaroi se nuk ka banuar në apartamentin e ndodhur në Burrel që prej vitit 1983, kur kishte nisur studimet në Fakultetin e Drejtësisë, dhe në vijim, pasi ishte emëruar në detyra të ndryshme në qytete të tjera. Po kështu, subjekti sqaroi se nuk ka marrë pjesë në procedurat për privatizimin e këtij apartamenti të kryera në emër të babait të tij, dhe se, që në vitin 1993 ka shprehur vullnetin për heqjen dorë nga pjesa takuese. Në këto kushte, sipas tij, mungesa e deklarinimit të pjesës takuese në deklaratën para fillimit të detyrës, ka qenë për shkak se nuk ka pasur asnjë lidhje apo përfitim nga kjo pasuri e paluajtshme.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar, bazuar në provat e administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni i vlerësoi bindëse deklarinimet e subjektit dhe çmoi se mosdeklarimi i 1/6 pjesë takuese në bashkëpronësinë e apartamenti në Burrel, është një pasaktësi që ka ardhur

¹ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. **** prot., datë 4.3.2019, nga ZVRPP-ja Mat, në dosjen e Komisionit.

² Shihni aktet në Aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

si pasojë e pakujdesisë për shkak të rrethanave, pasi është vërtetuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë lidhje, përfitim apo kontribut në këtë pasuri, referuar fakteve dhe provave, si vijojnë:

- i) privatizimi i banesës është kryer nga babai i subjektit. z. I. D. në cilësinë e kryefamiljarit në vitin 1993;
- ii) bashkëpronësia në emër të subjektit është për shkak të përfitimit në cilësinë e anëtarit madhor të familjes nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, për efekt të zbatimit të të cilit merret për bazë përbërja familjare në datën 1 dhjetor 1992;
- iii) është vërtetuar se subjekti ka filluar studimet e larta në vitin 1983 dhe në vitin 1987 me mbarimin e studimeve është larguar nga qyteti i lindjes për shkak të ushtrimit të detyrës në Kukës, Dibër dhe Mirditë. Si rrjedhim, *de facto*, subjekti është shkëputur nga pasuria që në vitin 1987, ndërkohë që është vërtetuar se ka hequr dore, *de jure*, nga pasuria në vitin 2016.

Në konkluzion, trupi gjykues krijoi bindjen se mosdeklarimi i pjesës prej 1/6 pjesë të pandarë të apartamentit me sip. 68 m² në DPFD-në për vitin 2003, nuk ka qenë me qëllim fshehjen e pasurisë. Në këto rrethana, pasaktësia në deklaram, nuk është konsideruar si pamjaftueshmëri në deklaram, që do të sillte si pasojë penalizim të subjektit të rivlerësimit.

2. Pronar i apartamentit të banimi me sip. 60 m², ndodhur në qytetin e Rrëshenit, Mirditë, z. k. ***, nr. pasurie ***, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***. Vlera: 275.800 lekë. Pjesa takuese: 50%, për të cilën subjekti ka deklaruar: “*Ky apartament është blerë nga Enti Kombëtar i Banesave me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.4.2001, dhe është shitur me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.4.2001, në vlerën 950.000 lekë*”.

Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* edhe pse sipas nenit 3/11 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcës nr. 2 “*Deklarata e Pasurisë* nuk ka pasur detyrimin e deklarimit, pasi në momentin e plotësimit të kësaj deklarate, pasuria (e shitur në vitin 2001) nuk ka qenë në pronësi të subjektit, vërtetuar edhe me informacionin e vënë në dispozicion nga ASHK-ja Mirditë³.

Duke qenë se shitja pasurisë nr. *** ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë nr. ***, apartament banimi me sip. 53.6 m², deklaruar në deklaratën *Vetting*, si në pikën 3 më poshtë, nga Komisioni është verifikuar: (i) mënyra ligjore e fitimit të pronësisë; dhe (ii) burimet që kanë shërbyer për blerjen e saj.

2.1. Në lidhje me fitimin e pronësisë, nga aktet⁴ në dosje rezultoi se:

- Me kontratë shitje apartamenti banimi me pagesë të njëhershme, datë 20.3.2001, z. Albert Demirneli, ka blerë nga EKB-ja Rrëshen, apartament banimi nr. ***, k. ***, shk. ***, ap. ***, me sipërfaqe shfrytëzimi 54 m². Kjo kontratë parashikon se z. Albert Demirneli ka statusin e të pastrehut, si dhe bazën ligjore të aplikuar për përlllogritjet e çmimit të shitjes për shkak të këtij statusi⁵ si: VKM-në nr .291, datë 21.6.1995 dhe VKM-në nr. 453, datë 21.8.1995.

³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2019, të ASHK-së Mirditë, në dosjen e Komisionit.

⁴ Shihni aktet në Aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

⁵ Në nenin II të kontratës “çmimi i shitjes së apartamentit” janë parashikuar: (a) vlera e apartamentit është 436.000 lekë; (b) në momentin e lidhjes së kontratës në bazë të VKM-së nr. 453, datë 21.8.1995 për një ndryshim në VKM-në nr. 291, datë 21.6.1995 “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve të ndërtuara me fonde shtetërore”, qytetari duhet të paguajë 4 % të vlerës së apartamentit për shpenzime operationale të Entit, vlerë e cila do të arkëtohet menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes, kjo vlerë është 58.600 lekë; (c) meqenëse blerësi ka statusin e të pastrehut në zbatim të VKM-së nr. 4, datë 9.1.1995; (d) sipas veprimeve të mësipërme çmimi i shitjes së apartamentit është 394.000 lekë; (e) në zbatim të VKM-së nr. 4, datë 9.1.1995, “Për uljen e çmimit të banesave të ndërtuara me fonde shtetërore në rastet e pagesës së menjëhershme nga blerësit”, zbriten 30 % të çmimit të apartamentit pa shpenzimet operationale, e barabartë me 119.000 lekë; (f) blerësi për blerjen e apartamentit pagoi 275.800 lekë.

- Me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.4.2001, shtetasit Albert Demirneli dhe M. D. kanë blerë nga EKB-ja Rrëshen pasurinë me nr. ***, në vlerën 275.800 lekë, shumë e cila është likuiduar me mandatin nr. ***, datë 2.4.2001⁶.

Pavarësisht se në kontratën e shitjes me pagesë të njehershme të datës 20.3.2001, parashikohet shprehimisht që pasuria është përfituar me statusin e të pastrehut, subjektit i është kërkuar gjatë procesit të rivlerësimit të japë sqarime dhe të vërtetojë me dokumente shkresore procedura të privatizimit të banesës nga EKB-ja Rrëshen me statusin e të pastrehut.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se pasi është caktuar Drejtues i Prokurorisë Mirditë me vendim të KLD-së, datë 1.7.1994, kishte jetuar në *** Rrëshen në periudhën shtator 1994 – shkurt 1996, dhe në këto kushte duke mos pasur një banesë, i ishte dhënë statusi i të pastrehut duke u pajisur nga EKB-ja Rrëshen me apartamentin e banimit nr. ***, k. ***, shk. ***, ap. ***, Rrëshen. Për të vërtetuar pretendimet e tij subjekti ka vënë në dispozicion dokumentat, si vijojnë:

- Vërtetim datë 11.3.2020 lëshuar nga administratori i ish-Hotel Turizmi Rrëshen, z. V. K., sipas të cilit vërtetohet se z. Albert Demirneli ka banuar si qiramarrës korrekt së bashku me bashkëshorten e tij në ish-Hotel Turizmi Rrëshen, nga shtator 1994 – shkurt 1996.

- Kërkesë e subjektit e datës 16.4.2020 drejtuar EKB-së Lezhë me anë të së cilës kërkohet dokumentacioni ligjor mbi statusin e të pastrehut, si dhe shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 6.7.2020, nga EKB-ja Lezhë, sipas të cilës ky institucion informon se nuk e disponon dosjen e tij dhe kontratën e shitblerjes së apartamentit, por ka vënë në dispozicion vendimin nr. 44, datë 19.10.2005, “Për miratimin e listës së të pastrehëve që përfitojnë kontribut nga shteti”, të Këshillit të Bashkisë Rrëshen, me anë të të cilit është miratuar lista e personave që kanë përfituar banesë nga EKB-ja Rrëshen si të pastrehë dhe përfitojnë kontribut sipas autorizimeve të lëshuara nga Bashkia Rrëshen, ndër të cilët edhe z. Albert Demirneli.

- Shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 17.7.2020, nga EKB-ja Tiranë, sipas të cilës ky institucion informon se pas verifikimeve të kryera në arkivën e drejtorisë së përgjithshme të EKB-së, si dhe Degës Rajonale të EKB-së Lezhë, nuk e disponon kontratën e shitblerjes së apartamentit, për shkak të një dëmtimi që ka ndodhur në ish-zyrat e EKB-së Mirditë.

Për sa më sipër, me gjithë përpjekjet e vërtetuara, subjekti nuk ka mundur të paraqesë dokumente që vërtetojnë procedura të privatizimit të banesës me statusin e të pastrehut dhe për këtë arsye me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet, si vijojnë: (i) në momentin e përfitimit të apartamentit në Rrëshen me statusin e të pastrehut, në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, subjekti ka qënë bashkëpronar me 1/6 pjesë takuese të pasurisë së apartamentit banimi me sip. 68 m², ndodhur në Burrel, privatizuar nga babai i subjektit, z. I. D.; (ii) nuk është administruar informacion e dokumentacion në lidhje me procedura të privatizimit të banesës nga EKB-ja Rrëshen me statusin e të pastrehut.

Në parashtrimet e tij të datës 30.11.2020, për sa i takon 1/6 pjesë takuese të apartamentit të ndodhur në Burrel, subjekti ka sqaruar se bashkëpronësia mbi këtë pasuri të privatizuar nga babai i tij me cilësinë e kryefamiljarit, nuk e ka penguar të përfitojë apartamentin në Rrëshen, pasi nuk ka banuar në atë apartament që prej vitit 1983 kur kishte nisur studimet në Fakultetin e Drejtësisë, ndërsa në vijim, në vitin 1987, ishte shkeputur përfundimisht pasi ishte emëruar në detyra të ndryshme në qytete të tjera. Gjithashtu, vijon të deklarojë se nuk ka pasur asnjë lidhje apo përfitim nga kjo pasuri.

⁶ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

Për sa i takon përfitimit të pasurisë në Rrëshen me statusin e të pastrehut, subjekti ka vijuar të deklarojë se pasi ishte transferuar për arsye pune në Rrëshen, në mungesë të një banese për t'u strehuar, ai i plotësonte të gjitha kriteret ligjore për të përfituar apartamentin e banimit në këtë qytet, në të cilën filloi të banonte që në vitin 1996 dhe e privatizoi me statusin e të pastrehut sipas dispozitave ligjore përkatëse⁷, vërtetuar me vendimin nr. 44, datë 19.10.2005, të Këshillit të Bashkisë Rrëshen. Ndërkohë, vijon të deklarojë se nuk ka mundur të sigurojë dokumentacion mbi procedurat e privatizimit dhe dosjen përkatëse, me gjithë përpjekjet që ka bërë ashtu sikurse edhe gjatë procesit të rivlerësimit, duke paraqitur edhe shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 23.4.2020, lëshuar nga Bashkia Mirditë, sipas të cilës ky institucion informon se dokumentet e kërkuara nuk disponohen.

Vlerësimi i Komisionit

Për sa i takon bashkëpronësisë mbi 1/6 pjesë të pandarë të pasurisë në Burrel, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se kjo pasuri nuk ka përbërë pengesë që subjekti të privatizonte apartamentin në Rrëshen me statusin e të pastrehut apo të ketë qenë në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", pasi:

- i) është vërtetuar që kjo pasuri është privatizuar nga babai i subjektit si kryefamiliar dhe subjekti ka përfituar bashkëpronësinë për shkak të moshës mbi 18 vjeç në momentin e privatizimit;
- ii) është vërtetuar se me mbarimin e studimeve të larta subjekti është shkëputur prej saj duke mos pasur në vijim asnjë lidhje, investim apo përfitim prej saj;
- iii) 1/6 pjesë e pandarë me pesë bashkëpronarët e tjerë të apartamentit me sip. 68 m² në Burrel, nuk mund të konsiderohet si sipërfaqe banimi e mjaftueshme për t'i shërbyer subjektit të rivlerësimit për strehim së bashku me bashkëshorten, në kuptim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", sipas të cilit, përbënte ndalesë nga përfitimi sipas këtij ligji, pasja e një banese jo më të vogël se normat e strehimit të familjes së subjektit si i pastrehë.

Ndërsa, për sa i takon vërtetimit të procedurave të privatizimit të banesës me dokumente shkresore, Komisioni vlerësoi se pavarësisht përpjekjeve, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të sigurojë aktet shkresore përkatëse, duke qenë në kushtet e mosparaqitjes së dokumenteve justifikuese për shkaqe të arsyeshme, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Por, pavarësisht mungesës së dokumentacionit që vërteton procedurat e privatizimit, në përfundim të procesit, bazuar në të gjitha sa është parashtruar më sipër në këtë vendim, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin se subjekti ka përfituar pa të drejtë me statusin e të pastrehut pasurinë apartament banimi në Rrëshen, referuar fakteve dhe provave, si vijojnë:

- i) Në periudhën e përfitimit të pasurisë, subjekti ka pasur vetëm bashkëpronësinë, *de jure*, mbi 1/6 pjesë të pandarë të apartamentit në Burrel, të përfituar nga babai i tij si kryefamiljar, pasuri e cila nuk përbente shkak për të mos përfituar banesë me statusin e të pastrehut sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha".
- ii) Kontrata e shitjes së apartamentit me pagesë të njëhershme, datë 20.3.2001, parashikon se blerësi Albert Demirneli ka statusin e të pastrehut dhe për këtë shkak përllogaritet për pagesën e çmimit të shitjes janë bërë sipas VKM-së nr. 291, datë 21.6.1995 dhe të VKM-së nr. 453, datë 21.8.1995.

⁷ Ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastrehë"; VKM-ja nr. 49, datë 29.1.1993, "Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët" dhe VKM-ja nr. 250, datë 16.4.1996, "Për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha".

iii) Vendimi nr. 44, datë 19.10.2005, “Për miratimin e listës së të pastrehëve që përfitojnë kontribut nga shteti”, i Këshillit të Bashkisë Rrëshen, me anë të të cilit është miratuar lista e personave që kanë përfituar banesë nga EKB-ja si të pastrehë dhe që përfitojnë kontribut sipas autorizimeve të lëshuara nga Bashkia Rrëshen, konfirmon emrin e subjektit të rilvlerësimit si i pastrehë. Për sa i takon faktit që ky vendim mban vitin 2005, ndërkohë që kontrata e shitjes është lidhur në vitin 2001, i pyetur gjatë seancës dëgjimore, subjekti u shpreh se në pikëpamjen tij, vendimi i Këshillit Bashkiak është marrë në vitin 2005 për ata persona që e kishin përfituar statusin, ndoshta për t’i hequr nga lista dhe për të bërë një inventar, por nuk është i sigurt se përse u mblodh këshilli në vitin 2005 për të kryer një procedurë të tillë, në një kohë që ai kishte hyrë në banesë që në vitin 1996. Pavarësisht vitit që mban ky vendim, dhe në kushtet e mungesës së dokumentacionit që vërteton procedura të privatizimit të banesës, në përfundim të procesit, Komisioni nuk mund të anashkalojë listën e personave që kanë përfituar banesë nga EKB-ja si të pastrehë dhe që përfitojnë kontribut sipas autorizimeve të lëshuara nga Bashkia Rrëshen, në të cilën bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, dhe aq me tepër të vejë në dyshim faktin e përfitimit me statusin e të pastrehut prej tij, për sa kohë kontrata e shitjes së pasurisë e vitit 2001 e parashikon këtë fakt, si dhe përllogaritjet e pagesës për çmimin e blerjes së pasurisë janë bërë sipas VKM-së përkatëse.

iv) Nuk u administrua asnjë e dhënë nga cilido burim i ligjshëm apo nga hetimi administrativ, që subjekti të ketë pasur në pronësi pasuri të paluajtshme në periudhën e përfitimit të pasurisë objekt shqyrtimi.

2.2 Për sa i takon burimit të krijimit të kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme, pasi u krye analiza financiare pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të deklaruara dhe të dokumentuara për të kryer pagesën në shumën prej 275.800 lekësh në datën 19.4.2001.

Përshkrimi	deri më 19.4.2001
PASURI	275.800
Apartament me sip. 60 m ² , Rrëshen (<i>blerë më 19.4.2001</i>)	275.800
TË ARDHURA	2.999.016
Të ardhura nga pagat subjekti	2.999.016
SHPENZIME	1.466.905
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	1.465.526
Paguar tatim në hipoteke	1.379
Mundësia për kursime	1.256.312

Periudha e analizuar është që nga emërimi në detyrë i subjektit më 1.1.1988 dhe deri në datën e blerjes së pasurisë. Metodologjia e përdorur është ajo kumulative, për shkak se blerja është kryer para deklarimit të parë të pasurisë në vitin 2003.

3. Pronar i apartamentit të banimit me sip 53.6 m², ndodhur në Rr. “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, z. k. ***, nr. pasurie ***. Vlera: 1.900.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %, për të cilin subjekti ka deklaruar se:

“Ky apartament është blerë në bazë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.5.2002, nga shtetasit A. dhe S. Th. Burimi i të ardhurave janë: shitja e apartamentit në qytetin e Rrëshenit, kursime nga paga si dhe hua prej 700.000 lekësh shtetasve R. K., S. N. dhe I. S. Kjo shumë është kthyer e gjitha në vite.

- Ky apartament është shitur me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2011, në vlerën 4.000.000 lekë”.

Pavarësisht se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, sipas nenit 3/11 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcës nr. 2 “*Deklarata e Pasurisë*”, subjekti nuk ka pasur detyrimin e deklarimit, pasi kjo pasuri është shitur në vitin 2011, konfirmuar edhe nga ZVRPP-ja Tiranë⁸. Duke qenë se shitja e kësaj pasurie në vlerën 4.000.000 lekë, është deklaruar si burim për blerjen e pasurisë nr. ***⁹, apartament banimi me sip. 109 m² në Tiranë, deklaruar në deklaratën *Vetting*, si në pikën 4 në vijim, gjatë hetimit administrativ është verifikuar: (i) mënyra ligjore e fitimit të pronësisë; dhe (ii) burimet që kanë shërbyer për blerjen e saj.

Pasuria me nr. ***⁹, apartament me sip. 53.6 m², ndodhur në Rr. “****”, p. ***⁹, shk. ***⁹, ap. ***⁹, është blere nga subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.5.2002⁹, nga shtetasit A. Th. e S. Th., në vlerën 1.900.000 lekë. Këtë pasuri, subjekti e ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003.

Në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e saj me të ardhura te ligjshme, gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	19.4.2001 – 9.5.2002
PASURI	1.900.000
Blerë apartament Rr. “****”, Tiranë	1.900.000
TË ARDHURA	1.529.838
Të ardhura nga pagat subjekti	579.838
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Burrel	950.000
SHPENZIME	355.530
Shpenzime jetese	350.780
Paguar tatim në burim për shitje pasurie	4.750
Mundësia për kursime kumulative	-725.692

Siç vërehet, në këtë analizë financiare, nuk është përfshirë si e ardhur ligjore huaja prej 700.000 lekësh të cilën subjekti e ka deklaruar si burim për blerjen e kësaj pasurie në DPFĐ-në për vitin 2003 por edhe në deklaratën *vetting*. Për të arritur në këtë përfundim, gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kryer verifikimet e mëposhtme:

Në DPFĐ-në për vitin 2003, subjekti ka deklaruar hua nga të afërmit në shumën 700.000 lekë për blerjen e apartamentit, marrë shtetasve R. K. (Angli,) S. N. (Itali) dhe I. S. (Tiranë), por pa përcaktuar shumat përkatëse të marra prej secilit. Në DPV-të në vijim për vitet 2004, 2006 dhe 2007, vit në të cilin ka deklaruar shlyerjen totale të huas, subjekti ka deklaruar rregullisht detyrimin e shlyer dhe atë të mbetur të huas. Në lidhje me shlyerjen e huas në total në shumën prej 700.000 lekësh, ka rezultuar se kjo shumë është likuiduar tërësisht sipas deklarimeve të subjektit. Konkretisht: (i) në vitin 2004 është deklaruar e likuiduar shuma 200.000 lekë; (ii) në vitin 2006 është deklaruar e likuiduar shuma prej 300.000 lekë; dhe (iii) në vitin 2007 është deklaruar e likuiduar shuma prej 200.000 lekësh. Subjekti ka pasur mundësi financiare për të shlyer këtë hua përgjatë viteve 2004, 2006 dhe 2007, pasi gjatë secilit prej viteve respektive, analiza financiare ka rezultuar me balancë pozitive.

I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se në momentin e marrjes në dorëzim të shumave nuk është hartuar asnjë dokument shkresor, duke

⁸ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 5.3.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë në dosjen e Komisionit.

⁹ Shihni Aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

deklaruar se prej shtetasit R. K. ka marrë hua në shumën 2.000 USD; prej shtetasit S. N., hua në shumën 2.000.000 lekë; prej shtetasit I. S., hua në shumën 2.000.000 lekë¹⁰. Për të vërtetuar pretendimet e tij subjekti ka vënë në dispozicion deklarata të këtyre shtetasve të cilët konfirmojnë deklaratimet e tij¹¹.

Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi me këta shtetas, nuk u vërtetua që subjekti të ketë pasur për shqyrtim çështje penale të këtyre shtetasve¹². Gjithashtu, nuk u vërtetuan procedime penale të regjistruara ndaj këtyre shtetasve¹³.

Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të këtyre shtetasve në periudhën e dhënies së huave, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, në zbatim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti vuri në dispozicion dokumente shkresore nga verifikimi i të cilave rezultoi se:

- Për shtetasin S. N., subjekti ka vërtetuar të ardhura në shumën 1.711 euro për vitin 2000 dhe janar 2001, pa llogaritur shpenzimet e jetesës, shumë e cila në përfundim të hetimeve paraprake, nuk u konsiderua e mjaftueshme për dhënien e huas në shumën prej 200.000 lekësh, dhe për këtë arsye, kjo hua nuk është përfshirë si e ardhur ligjore në analizën financiare të vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ.

- Për shtetasin I. S., subjekti ka vërtetuar vetëm marredhëniet e punësimit të këtij shtetasi, por nuk vërtetohen të ardhura të ligjshme të tij dhe, për rrjedhojë, huaja prej 200.000 lekësh nuk është përfshirë si e ardhur në analizën financiare.

- Për shtetasin R. K., nga subjekti nuk u paraqit dokumentacion justifikues dhe për rrjedhojë, huaja prej 2.000 USD/300.000 lekë nuk është përfshirë si e ardhur në analizën financiare.

Vlen të theksohet se meqenëse apartamenti objekt shqyrtimi është blerë në periudhën përpara deklaratimit të parë, metodologjia e përdorur është ajo kumulative duke u analizuar periudha nga blerja e apartamentit në Rrëshen, datë 19.4.2001, deri në blerjen e apartamentit në Tiranë në datën 9.5.2002. Në analizën financiare si të ardhura të ligjshme janë përfshirë: pagat e dokumentuara të subjektit për periudhën e analizuar, shuma e përfutur nga shitja e apartamentit në Burrel në datën 27.4.2001 prej 950.000 lekësh dhe shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së dhe përbërjes familjare të subjektit¹⁴.

Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i ka kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me konstatimet, duket se: (i) subjekti nuk ka provuar me dokumente ligjore në formën e kërkuar nga ligji të ardhura të ligjshme të huadhënësave për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie për shkak të një balance negative në vlerën 725.692 lekë, rezultuar për shkak të mosmarrjes në konsideratë të huas prej 700.000 lekësh.

¹⁰ Subjekti i ka shprehur shumat në lekë të vjetra. Duket që është një lapsus në përgjigjet e pyetësorit, pasi në DPV-të subjekti ka deklaruar gjithmonë me lekë të reja.

¹¹ Shihni deklaratën e thjeshtë të shtetasit S. N. të datës 12.3.2020; deklaratë të thjeshtë të shtetasit R. K., të datës 13.3.2020; deklaratë noteriale të shtetasit I. S., të datës 17.3.2020 bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

¹² Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot A/D, datë 20.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në dosjen e Komisionit.

¹³ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** Prot., datë 29.9.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Deri në datën 13.2.2002 (lind djal) shpenzimet janë përlogaritur për 3 persona dhe pas lindjes së djalit deri më 9.5.2002 shpenzime për 4 persona.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur sqarime, prova e dokumenta shkresore për të kundërshtuar barrën e provës, si vijon:

Se pari, në lidhje me të ardhurat e huadhënësve për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, subjekti ka sqaruar se në momentin e marrjes së huave në vitin 2001, nuk kishte pasur detyrim ligjor t'u kërkonte huamarrësve dokumentacion ligjor mbi burimin e krijimit të ardhurave, por i ka deklaruar këto shuma për të qenë korrekt pavarësisht se huat janë marrë disa vite para miratimit të ligjit për deklarimin e pasurive.

Për sa i takon huadhënësit S. N., i cili punon dhe jeton në Itali prej vitit 1996 dhe z. R. K., i cili punon dhe jeton në Angli, subjekti ka këmbëngulur se ata kanë pasur mundësi për dhënien e huave në shumat përkatëse prej 200.000 lekësh dhe 2.000 USD, por këto vendime mbeten në nivel deklarativ pasi nuk është paraqitur asnjë provë për ti vërtetuar.

Për sa i takon huadhënësit I. S., subjekti ka pretenduar se ky shtetas ka pasur mundësi për të dhënë huan prej 200.000 lekësh në vitin 2001, duke dokumentuar të ardhura nga paga të tij për vitet 1994 dhe 1995. Ndërkohë në analizën financiare të paraqitur prej tij, ka llogaritur të ardhura të siguruara nga prodhimi bujqësor dhe blegtoral në 1/7 pjesë takuese të tokës bujqësore në fshatin ***, Durrës dhe minimumin jetik për vitet 1994 – 2000¹⁵. Për të vërtetuar këto pretendime subjekti ka depozituar disa dokumente shkresore¹⁶.

Së dyti, në lidhje me balancën negative në vlerën 725.692 lekë, vënë në dispozicion me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti e ka prapësuar këtë konstatim, me pretendimin se gjatë analizës financiare duhet pranuar metodologjia kumulative, meqenëse jemi para deklarimit të 1-rë. Në këto kushte, sipas subjektit, mundësia për kursime prej 1.256.312 lekësh, deri në datën 19.4.2001, që ka rezultuar edhe nga përllogaritjet e Komisionit, duhet të përfshihet në analizën financiare për blerjen e pasurisë apartament në datë 9.5.2002.

Qëndrimi i Komisionit

Se pari, në analizë të pretendimeve dhe dokumentave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, sa i takon të ardhurave që kanë shërbyer si burim për dhënien e huave, rezulton se për huadhënësit S. N., i cili punon dhe jeton në Itali prej vitit 1996 dhe z. R. K., i cili punon dhe jeton në Angli, subjekti nuk ka paraqitur prova që të ndryshonin konstatimin fillestar të rezultateve të hetimit lidhur me huat e marra prej secilit prej tyre, në total në shumën prej 500.000 lekësh.

Sa i takon huadhënësit z. I. S., bazuar në dokumentat që subjekti ka paraqitur pas kalimit të barës së provës, duket se për periudhën shtator 1990 – nëntor 1995¹⁷, ai ka pasur të ardhura nga paga në shumën totale prej 494.720 lekësh, duke konsideruar shpenzimet e jetesës në masën 50% të të ardhurave për shkak të konsumit të produkteve nga toka bujqësore në bashkëpronësi.

¹⁵ Për shkak të mungesës së legjislacionit për përcaktimin e shpenzimeve të jetesës, ato janë përllogaritur nga eksperti kontabël si mesatare e thjeshtë midis pagës minimale dhe pagesës së papunësisë.

¹⁶ Analizë financiare; vërtetim nr. ***, datë 25.11.2020, nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan; vërtetim nga ISSh-ja mbi pagën e z. I. S. për periudhën 1.1.1994 – 28.2.1995 si i punësuar në Drejtorinë e Policisë Elbasan; vërtetim nga ISSh-ja mbi pagën mars - nëntor 1995 si i punësuar në Drejtorinë e Policisë Lezhë; akti nr. *** i marrjes në pronësi të tokës, datë 21.10.1992 në fshatin ***, Durrës; certifikatë familjare datë 7.8.2017, e cila tregon se familja ka në përbërje të saj 7 anëtarë në datën 1.8.1991.

¹⁷ Shkresa e ISSh-së informon mbi pagat e z. I. S. në shumën 231.920 lekë si i punësuar në Drejtorinë e Policisë Elbasan dhe Lezhë, përkatësisht për periudhat 1.1.1994 – 28.2.1995 dhe 28.2.1995 – nëntor 1995. Nga vërtetimi nr. ***, datë 25.11.2020, i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, rezulton se për z. I. S., ish-punonjës policie në Komisaratin e Policisë Librazhd, nuk mund të lëshohet vërtetim page *bruto* dhe *neto* për periudhën 1.9.1990 – 31.12.1993, pasi listëpagesat mungojnë. Meqenëse subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë subjektive, për këtë periudhë, janë përllogaritur të ardhura në shumën 262.800 lekë, duke përdorur si pagë reference, pagën e janarit të vitit 1994, si muaji më i afërt për të cilin ka informacion shkresor.

Ndërsa për vitet në vijim 1995 – 2000, subjekti nuk ka paraqitur dokumente shkresore për të vërtetuar të ardhura.

Në keto kushte, në pamundësi për të kryer një analizë financiare të pasurive dhe të ardhurave të shtetasit I. S., për shkak të mungesës së të dhënave, Komisioni nuk mund të arrijë në një përfundim nëse ky shtetas ka pasur ose jo mjaftueshëm të ardhura për të dhënë subjektit të rivlerësimit huan prej 200.000 lekësh në vitin 2001. Por, duke i qëndruar strikt dokumenteve që subjekti ka paraqitur, Komisioni çmoi të mos e përfshijë huan prej 200.000 lekësh në rubrikën “të ardhura” të analizës financiare përfundimtare të kryer për blerjen e pasurisë në vitin 2001.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti nuk vërtetoi burimin e ligjshëm të huas në total prej 700.000 lekësh dhe, për rrjedhojë, kjo shumë nuk u përfshi si e ardhur ligjore në analizën financiare.

Së dyti, në lidhje me kundërshtimin e balancës negative të analizës financiare në vlerën - 725.692 lekë, me pretendimin se gjatë analizës financiare duhet pranuar metodologjia kumulative, Komisioni arsyeton se, është e vërtetë që subjekti ka pasur mundësi të krijojë kursime me të ardhura të ligjshme në shumën prej 1.256.312 lekësh¹⁸, për periudhën nga emërimi i tij në detyrë në vitin 1988 dhe deri më 19.04.2001, vërtetuar me dokumentet shkresore të administruara gjatë hetimit administrativ, të ardhura të cilat nuk ishin përfshirë si e ardhur ligjore në analizën financiare të vënë në dispozicion të subjektit me rezultatet e këtij hetimi¹⁹. Po kështu, është e vërtetë se në DPFD-në për vitin 2003 subjekti nuk i ka deklaruar kursimet nga të ardhurat e pagave si burim të blerjes së pasurisë objekt shqyrtimi në vitin 2001. Por në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë edhe këto të ardhura, në përmbushje të detyrimit ligjor parashikuar në shtojcën nr. 2, “Deklarata e pasurisë” të ligjit nr. 84/2016. Po kështu, i pyetur gjatë procesit mbi burimin e saktë të blerjes së këtij apartamenti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi të njëjtat burime si ato të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

Në këto kushte, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi të marrë në konsideratë si të bazuar pretendimin e subjektit, duke e përfshirë në analizën financiare si të ardhur ligjore shumën prej 1.256.312 lekësh për blerjen e pasurisë së ndodhur në Rr. “***”, Tiranë, në datën 9.5.2002, referuar fakteve dhe rrethanave, si vijojnë:

i) Subjekti e ka deklaruar pasurinë objekt shqyrtimi në deklaratën *vetting* edhe pse nuk e ka pasur detyrim sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se në momentin e plotësimit të kësaj deklarate e kishte humbur pronësinë mbi këtë pasuri.

ii) Deklarata për vitin 2003 ka qenë deklarimi i parë i pasurisë dhe ashtu sikurse është evdidentuar dhe në raste të ngjashme të vlerësuar nga Komisioni, subjektet kanë qenë të paqartë për plotësimin e saj.

iii) Komisioni vlerëson peshën dhe epërsinë e deklaratës *Vetting* në raport me deklarinimet periodike, në kuptim të pikës 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilës subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë duke plotësuar shtojcën nr. 2 “Deklarata e pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, për sa i takon të ardhurave të dokumentuara dhe të kursyera prej pagave për periudhën nga emërimi i tij në detyrë dhe deri në datën 9.5.2002, aq më tepër në kushtet, kur nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim i ligjshëm apo nga të

¹⁸ Kjo shumë është mundësia e subjektit për të pasur fonde të lira që rrjedhin nga të ardhura nga pagat, e krijuar si diferencë e të ardhurave me shpenzimet kumulative të subjektit që nga emërimi i tij në detyrë e deri më 19.1.2001, sikurse analizuar në pikën 2.1. të këtij vendimi, analiza për periudhën “deri më 19.4.2001”.

¹⁹ Në këtë analizë ishin përfshirë të ardhurat nga blerja e apartamentit në Rrëshen datë 19.4.2001 deri në blerjen e apartamentit në Tiranë në datën 9.5.2002.

dhënat e hetimit administrativ, për pasuri dhe shpenzime të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë kësaj periudhe, përveç atyre të deklaruara prej tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare me ndryshimet përkatëse duke përfshirë si të ardhur ligjore shumë prej 1.256.312 lekësh, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, nga ku rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit me sip. 53.6 m², ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, në çmimin 1.900.000 lekë, në datën 9.5.2002.

Përshkrimi	<i>deri në 9.5.2002</i>
PASURI	1.900.000
Blerë apartament në Rr. “****”, Tiranë	1.900.000
TË ARDHURA	2.986.150
Të ardhura nga pagat subjekti	579.838
Të ardhura nga shitjet e pasurise	950.000
Kursime nga periudha të kaluara	1.256.312
SHPENZIME	355.530
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	350.780
Paguar tatim në burim për shitje pasurie	4.750
Mundësia për kursime	530.620

Por, për efekt të të qenit sa më objektiv në këtë proces, Komisioni ka kryer përlllogaritjet e mundësisë financiare për blerjen e pasurisë nga subjekti, në variantin duke mos marrë në konsideratë kursimet kumulative për periudhën nga emërimi i tij në detyrë në vitin 1988 dhe deri në 19.04.2001, në shumë prej 1.256.312 lekësh dhe as huat në shumë prej 700.000 lekësh, për shkak të mosjustifikimit të shumës me të ardhura të ligjshme të huadhënësve. Në këtë rast, balanca negative do të ishte në shumë prej -725.692 lekësh, e cila nga Komisioni nuk mund të konsiderohet si pamjafueshmëri në deklarime sipas parashikimit të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, nuk do të përbënte shkak për penalizim të subjektit, në proporcion me të gjitha faktet dhe rrethanat, si vijojnë:

i) Pasuria objekt shqyrtimi, për të cilën janë deklaruar si burim huat në vlerën totale prej 700.000 lekësh, është përfituar në vitin 2001, përpara periudhës së rivlerësimit dhe pavarësisht këtij fakti, subjekti ka kryer deklarime të sakta dhe të detajuara në DPV, në deklaratën *Vetting*, duke vijuar me deklaratimet në procesin e rivlerësimit, gjatë të cilit ai ka treguar përkushtim maksimal për të vërtetuar sa i është kërkuar nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri dhe burimet që kanë shërbyer për blerjen e saj.

ii) Në DPFĐ-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar huan si burim për blerjen e pasurisë në vitin 2001.

iii) Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe rregullisht në vitet në vijim, shumat e shlyera të huas dhe detyrimet financiare të mbetura, deri në vitin 2007, kur është deklaruar shuarja e detyrimit.

iv) Subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për shlyerjen e huas në të gjitha vitet e deklaramit.

v) Periudha e hershme e marjes së tre huave në vlerën totale prej 700.000 lekësh, ka vështirësuar objektivisht evidentimin e të ardhurave të dy huadhënësve emigrantë dhe një huadhënësi të punësuar në Shqipëri, për të cilin subjekti ka vërtetuar pamundësinë objektive

për të vërtetuar të ardhurat e tij të punësimit në Komisarriatin e Policisë Librazhd²⁰, ashtu sikurse, edhe mundësinë e Komisionit për të kryer një analizë financiare të mirëfilltë të pasurive dhe të ardhurave të huadhënësve, me qëllim vlerësimin e mundësisë së tyre financiare për dhënien e huave me të ardhura të ligjshme.

4. Pronar i apartamentit të banimit me sip.107 m², ndodhur në Rr. “****”, Pallati i ****, shk. ****, ap. ****, Tiranë. Vlera: 42.800 euro. Pjesa takuese: 50 %. E pahipotekuar, për të cilin subjekti ka deklaruar:

“Ky apartament është blerë në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë 9.10.2009, nga shoqëria “****” sh.p.k.

Burimi i të ardhurave janë: (1) shitja e e apartamentit në Rr. “****”, p. ****, shk. ****, z. k. ****, në vlerën 4.000.000 (kater milion) lekë; dhe (2) kursimet nga paga ime dhe e bashkëshortes”.

Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me statusin aktual të kësaj pasurie rezultoi se:

- ZVRPP-ja Tiranë²¹ konfirmoi se z. Albert I. Demirneli ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë nr. ****, apartament me sip. 99.4 m², regjistruar në datën 17.7.2017, blerë me kontratë shitje nr. ****, datë 5.7.2017. Siç vërehet, pasuria është blerë pas plotësimit të deklaratës *Vetting*, dhe kjo është arsyeja përse pasuria është deklaruar e pahipotekuar. Për sa i takon sipërfaqes, subjekti ka deklaruar sipërfaqen prej 107 m², e cila përputhet me sipërfaqen e parashikuar në kontratën e sipërmarrjes dhe në kontratën e shitjes. Ndërsa, ZVRPP-ja Tiranë konfirmon sipërfaqen prej 99.4 m². Duket se, mospërputhja në deklarime është për shkak të mosregjistrimit të sipërfaqes së ambienteve të përbashkëta prej 7.6 m².

- OSHEE-ja²² informoi se shtetasi Albert Demirneli është abonent me nr. kontrate ****, në instancën e Tiranës, ku referuar detajeve të klientit kjo kontratë i përket adresës së pasurisë objekt shqyrtimi me adresë në Rr. “****”.

4.1 Në lidhje me origjinën, mënyrën e krijimit të pasurisë dhe likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë, nga aktet në dosje, në rend kronologjik, rezultoi se janë kryer veprimet, si vijojnë:

- me kontratën e sipërmarrjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë 9.10.2009, porositi Albert Demirneli ka porositur nga sipërmarrësi “****” sh.p.k., apartamentin nr. ****, 2+1, me sipërfaqe 107 m², kati i tretë, Rr. “****”, në shumën 400 euro/m², ose në total 42.800 euro;

- me certifikatë për vërtetim pronësie, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, datë 21.10.2016, apartamenti me sip. 94 m², pasuria me nr. ****, është i regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. (****);

- me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. **** rep., nr. **** kol., datë 5.7.2017, shtetasi Albert Demirneli ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., apartament me nr. pasurie ****, në çmimin 42.800 euro, likuiduar totalisht jashtë kësaj zyre noteriale sipas kontratës së sipërmarrjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë 9.10.2009;

- sipas kartelës së pasurisë, pasuria nr. ****, është regjistruar në datën 17.7.2017, në emër të shtetasit Albert Demirneli.

I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, në lidhje me likuidimin e çmimit prej 42.800 euro, në përgjigjet e pyetësorit shtesë të datës 6.4.2020, subjekti ka sqaruar se e ka kryer këtë pagesë pranë zyrës së financës së shoqërisë, ditën e redaktimit të kontratës së sipërmarrjes, ashtu

²⁰ Shihni vërtetimin nr. ****, datë 25.11.2020, të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, nga ku rezulton se për z. I. S., ish-punonjës policie në Komisarriatin e Policisë Librazhd, nuk mund të lëshohet vërtetim page *bruto* dhe *neto* për periudhën 1.9.1990 – 31.12.1993, pasi listëpagesat mungojnë.

²¹ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ****prot., datë 5.3.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë në dosjen e Komisionit.

²² Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. **** prot., datë 24.3.2019, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

sikurse kjo kontratë parashikon, duke paraqitur mandatarkëtimin e datës 9.10.2009, me përshkrim “*likujdim i vlerës së apartamentit sipas kontratës nr. ****”.

4.2 Në lidhje me trajtimin e mundshëm preferencial, për blerjen e kësaj pasurie

Referuar udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2010”, rezulton se për zonën 11/3 ku ndodhet apartamenti në Laprakë, çmimi në tregun e lirë është 64.000 lekë/m². Për rrjedhojë, apartamenti do të kushtonte 99.4 m² X 64000 m² = 6.361.600 lekë, ndërkohë që është blerë me çmimin 42.800 euro ose 5.870.876 lekë. Pra, subjekti e ka blerë pasurinë më lirë sesa çmimi i tregut, me një diferencë 490.724 lekë.

Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi me shtetasit M. J. administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., dhe shtetasit N. J., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. (****) nuk u vërtetua që subjekti të ketë pasur për shqyrtim çështje penale të këtyre shtetasve²³.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk ka pasur të dhëna si dhe nuk rezultuan elemente të trajtimit të mundshëm preferencial të subjektit në blerjen e pasurisë, për shkak të ushtrimit të detyrës si prokuror. Por, pavarësisht këtij konstatimi, në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë trajtim preferencial në blerjen e pasurisë, dhe për të vërtetuar pretendimet e tij ka vënë në dispozicion dy kontrata shitblerje të pasurive²⁴, ku çmimi i shitjes së apartamenteve të ndodhura në të njëjtin pallat, përkon me çmimin e blerjes së pasurisë nga subjekti i rivlerësimit.

4.3 Në lidhje me deklarin e kësaj pasurie, rezultoi se:

- Në deklarin për vitin 2009, është deklaruar: “*Blerje apartamenti me sip 107 m², në Rr. ****, me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2009. Blerja e këtij apartamenti është kryer nga shitja e apartamentit me kontratë shitje apartamenti me sip 53.6 m², me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2009, në shumën 4.000.000 (katër milionë) lekë.*”

- Ne deklaratën *Vetting*, në deklarin e pasurisë nr. ****, me sip. 53.6 m², ndodhur në Rr. “****”, trajtuar në pikën 3 më sipër, subjekti ka deklaruar: “*Ky apartament është shitur me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2011, në vlerën 4.000.000 lekë*”.

Siç vërehet, për pasurinë apartament banimi me sip. 53.6 m² ndodhur në Rr. “****”, në DPV-në për vitin 2009 është deklaruar shitja e kësaj pasurie me nr. ****me kontratë të datës 9.10.2009, ndërsa në deklaratën *Vetting*, është deklaruar shitja me kontratë të datës 2.11.2011.

4.4 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie: (i) shitja e apartamentit në Rr. “****”, p. ****, shk. ****, z. k. ****, në vlerën 4.000.000 (katër milionë) lekë; (ii) kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

4.4.1 Analizë e burimit “shitja e apartamentit në Rr. “****”

Në lidhje me këtë pasuri, nga verifikimi i akteve në dosje²⁵, u konstatua se:

²³ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 14.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot. ****, datë 20.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në dosjen e Komisionit.

²⁴ Shihni kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.11.2016 me objekt shitje apartamenti me sip. 75 m² në çmimin 29.050 euro dhe kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.11.2016, me objekt shitje apartamenti me sip. 75 m² në çmimin 29.000 euro.

²⁵ Shihni aktin në Aneksin 38 dhe Aneksin 4/4/ në dosjen e ILDKPKI-së.

- Me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2009, shtetasi Albert Demirneli me pëlqimin e bashkëshortes M. Demirneli i ka shitur shtetasit R. H. apartamentin e banimit me nr. pasurie ***, me sip 53.6 m², në Rr. “****”, në vlerën 4.000.000 lekë likuiduar jashtë zyrës noteriale. Kjo kontratë është deklaruar në DPV-në për vitin 2009, si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi në Rr. “****”.

- Me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2011, shtetasi Albert Demirneli, me pëlqimin e bashkëshortes M. Demirneli i ka shitur të njëjtit blerës, shtetasit R. H., të njëjtin apartament, me nr. pasurie ***, me sip 53.6 m², në të njëjtën vlerë prej 4.000.000 lekësh, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale, por pa specifikime të metëjshme. Ndërkohë që në DPV-në për vitin 2011, subjekti ka deklaruar: *“Apartamenti prej 53.6 m², shitur me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2009, me vlerë 4.000.000 lekë, është rivlerësuar në muajin dhjetor 2010 me vlerë vlerësimi 3.644.800 lekë, sipas kontratës së rivlerësimit (lapsus në deklarim, pasi është kontratë shitje) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2011. Shpenzime rivlerësimi në vlerën 17.448 lekë.*

Bazuar në dokumentacionin e administruar si më sipër, vërehet se për apartamentin në Rr. “****”, pasuria nr. ***, janë redaktuar dy kontrata shitjeje, njëra në vitin 2009 dhe tjetra në vitin 2011, të dyja me të njëjtin blerës dhe në të njëjtin çmim shitjeje, kontrata të cilat subjekti i ka deklaruar në të dyja DPV-yë, atë për vitet 2009 dhe 2011.

Për të qartësuar situatën në lidhje me këtë konstatim, si dhe me qëllim evidentimin e periudhës së përfitimit të shumës prej 4.000.000 lekësh, deklaruar si burim i ligjshëm i të ardhurave për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi në Rr. “****”, nga Komisioni u kryen disa veprime hetimore, si vijojnë:

Se pari, u pyet subjekti në lidhje me: (i) ekzistencën e dy kontratave të shitjes për të njëjtën pasuri; (ii) rivlerësimin e pasurisë në vitin 2010, ndërkohë që subjekti e kishte shitur pasurinë në vitin 2009; si dhe (iii) në lidhje me momentin e regjistrimit të pasurisë në emër të blerësit. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se: *... në datën 7.10.2009, unë këtë apartament ia kam shitur shtetasit R. H., i cili ka marrë po atë datë në dorëzim apartamentin. Sipas marrëveshjes, blerësi do të bënte edhe pagesën për kalimin e pronësisë pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë Tiranë. Që nga ajo kohë e në vazhdim, shtetasi R. H. nuk e ka ndjekur këtë procedurë dhe për rrjedhojë nuk ka kryer pagesën për kalimin e pronësisë në favor të tij. I kam kërkuar në mënyrë sistematike këtij të fundit që të kryente veprimet përkatëse pranë ZVRPP-së Tiranë, por nga ana e tij kjo procedurë është neglizhuar dhe më ka kërkuar që të kryeja pagesën për kalimin e pronësisë. Ndodhur në këto kushte, në vitin 2010 kam kryer rivlerësimin e apartamentit pranë ZVRPP-së Tiranë, pasi ‘de jure’ figuroja pronar i apartamentit. Pas kryerjes së kësaj procedure është lidhur një tjetër kontratë shitjeje për të njëjtin apartament. Pra arsyeja pse ekzistojnë dy kontrata shitjeje për një objekt ka qenë fakti i mospagimit në kohë të detyrimeve për kalimin e pronësisë ...”.*

Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti paraqiti disa dokumente shkresore nga verifikimi i të cilave, në mënyrë të përmbledhur u konstatua se:

- Me formularin e aplikimit të datës 2.11.2011, për rivlerësimin e pasurisë nr. ***, z. k. ***, me adresë në Rr. “****”²⁶, apartament me sip. 53.6 m², pasqyrohet vlera e pasurisë në shumën 3.644.800 lekë, si dhe tatimi i paguar në vlerën 17.448 lekë²⁷.

- Me akt bankar të datës 2.11.2011 të “Credins Bank”, rezulton të jetë paguar tatimi 1% mbi RVP-në, në shumën prej 17.448 lekësh.

²⁶ Rivlerësimi është bërë bazuar në ligjin nr. 10418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”.

²⁷ Tatimi i paguar është 1 % mbi diferencën e çmimit minimal fiskal të vitit 2011 dhe çmimit të blerjes sipas kontratës së shitblerjes.

- Po në datën 2.11.2011, është lidhur kontrata e dytë e shitjes së pasurisë të shtetasi R. H.
- Në datën 28.3.2012 (afërsisht tre muaj më vonë pas redaktimit të kontratës së dytë më 2.11.2011), shtetasi R. H. ka aplikuar pranë ZVRPP-së Tiranë për regjistrimin e pasurisë nr. ***. Sipas këtij aplikimi, pagesa totale është 63.480 lekë, e cila përbëhet nga: (i) shuma 16.080 lekë tatim mbi kalimin e pronësisë; (ii) shuma 450 lekë taksë pulle; (iii) shuma 46.950 lekë nga shërbime dhe gjoba. Siç vërehet, është parashikur gjobë për shkak të aplikimit me vonësë, jashtë afatit një mujor të regjistrimit.
- Sipas kartelës së lëshuar në ZVRPP-në ku është pasqyruar rivlerësimi i pasurisë në shumën 3.644.800 lekë, rezulton që pasuria me nr. ***, është regjistruar në emër të blerësit R. H., me kontratë shitje të datës 2.11.2011.

Së dyti, u pyet subjekti në lidhje me mënyrën e likuidimit të shumës 4.000.000 lekë prej blerësit R. H., dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 3, z. A. Demirneli, sqaroi se kjo shumë është likuiduar nga blerësi dorazi dhe jashtë zyrës noteriale në datën 7.10.2009, që është data e lidhjes së kontratës së parë nr. *** rep., nr. *** kol, kontratë e cila parashikon likuidimin e çmimit të shitjes jashtë zyrës noteriale. Tre dite më vonë, datë 9.10.2009, kjo shumë u përdor për blerjen/porositjen e apartamentit objekt shqyrtimi në Rr. “****”, me kontratën e sipërmarjes nr. *** rep., nr. *** kol., duke u depozituar pranë zyrës së financës së shoqërisë së porositur “****” sh.p.k., sipas mandatpagesës, datë 9.10.2009.

Së treti, i pyetur në lidhje me momentin e largimit nga apartamenti i banimit të shitur z. R. H. në Rr. “****” duke e vërtetuar këtë fakt me dokumente, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se prej periudhës tetor 2009, kur kjo pasuri iu shit këtij shtetasi, është shpërngulur familjarisht në apartamentin e ri të blerë në Rr. “****”, ***, Tiranë (apartamenti i deklaruar në deklaratën *Vetting* objekt shqyrtimi). Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti paraqiti dokumentet shkresore, si vijon:

- Vërtetim me datë 24.9.2009, të administratorit të shoqërisë “****”²⁸ sh.p.k., sipas të cilit vërtetohet se në këtë periudhë subjekti ka qenë banor i apartamentit me nr. 1, në Rr. “****”, duke marrë në dorëzim kontratën e energjisë elektrike me nr. *** dhe kontratën e ujit nr. ***.
- Librezat e furnizimit me energji dhe ujë në emër të subjektit, në të cilat konfirmohet se ka pasur pagesa për shpenzim të energjisë elektrike dhe ujë, për apartamentin në Rr. “****” që në vitin 2009. Informacioni për pagesën e energjisë elektrike u provua të jetë i vërtetë nga OSHEE-ja e cila, me kërkesë të Komisionit, konfirmoi se kontrata e furnizimit me energji nr. *** në instancën Tiranë, është në emër të shtetasit Albert Demirneli, si dhe pagesat për shpenzimin e energjisë nisin që në gusht të vitit 2009.

Së katërti, pas kërkesës së Komisionit, ZVRPP Tiranë paraqiti një informacion të detajuar²⁹, i cili përputhet plotësisht me deklaratimet dhe dokumentet që subjekti ka vënë në dispozicion. Konkretisht, kjo zyrë ka informuar se: (i) pasuria nr. ***, e llojit apartament me sip. 53.6 m², sipas gjendjes juridike aktuale është në pronësi të shtetasit R. H., i pajisur me çertifikatë pronësie në datën 20.4.2012, pa asnjë shënim në seksionin “D” dhe “E” të kartelës së pasurisë; (ii) kjo pasuri ka si origjinë kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.11.1993 me palë shitëse Ndërmarrjen Komunale Banesa, me palë blerëse A. e S. Th., të cilat ia kanë shitur shtetasit Albert Demirneli sipas kontratës së shitjes nr. ***rep., nr. *** kol., datë 9.5.2002; (iii) sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2011, shtetasi Albert Demirneli e ka tjetërsuar pasurinë në favor të shtetasit R. H.. Pra, siç vërehet, kontrata e shitjes me nr. ***

²⁸ Shihni kontratën e sipërmarjes²⁸ “Për punime ndërtimi” datë 8.7.2006, mes shoqërisë “****” dhe investitorit “****” sh.p.k., bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit të datës 13.5.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. ***, datë 20.5.2020, nga subjekti në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 11.5.2020, nga ASHK-ja Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

rep., nr. *** kol., datë 7.10.2009, në favor të shtetasit R. H., nuk është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë.

Së pesti, pas verifikimeve të kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nuk u vërtetua që subjekti të ketë pasur për shqyrtim çështje penale që i përkasin shtetasit R. H.³⁰. Po kështu, në ngarkim të këtij shtetasi nuk u vërtetuan të regjistruara procedime penale për vepra të përfshirjes në krimin e organizuar³¹.

Nga gjithë informacioni i administruar, lidhur me pasurine nr. ***, me adresë në Rr. “****” dhe pasurinë nr. *** me adresë në Rr. “****”, deklaruar në deklaratën *Vetting*, në përfundim të hetimit administrativ, në mënyrë të përmbledhur u vërtetua se:

- i) me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2009, pasuria nr. ***, i është shitur shtetasit R. H., në çmimin 4.000.000 lekë;
- ii) në vitin 2009, subjekti është larguar nga apartamenti i shitur në Rr. “****”, pasuria me nr. ***, për të filluar jetesën në apartamentin në Rr. “****”, pasuria me nr. ***, deklaruar në deklaratën *Vetting*;
- iii) në DPV-në për vitim 2009, në pjesën e deklaramit të interesave private të personit të lidhur (që duhej plotësuar nga bashkëshortja në fakt), subjekti Albert Demirneli ka deklaruar si adresë të regjistrimit në Gjendjen Civile adresën: Rr. “****”;
- iv) në DPV-në për vitin 2009, subjekti e ka deklaruar shitjen e pasurisë nr. ***, Rr. “****”, si burim për blerjen e pasurisë, apartament banimi objekt shqyrtimi nr. ***, në Rr. “****”;
- v) deri në datën 2.11.2011, shtetasi R. H. nuk e ka regjistruar në emër të tij pasurinë nr. ***, blerë me kontratën datë 7.10.2009;
- vi) në datën 2.11.2011, është bërë rivlerësimi i pasurisë nr. *** nga pronari *de jure* i saj, subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, i cili ka paguar tatimin (1%) në vlerën 17.448 lekë;
- vii) me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2011, subjekti i rivlerësimit ia ka shitur përsëri pasurinë nr. ***, në Rr. “****”, shtetasit R. H.;
- viii) në datën 28.3.2012, shtetasi R. H., ka aplikuar për regjistrimin e pasurisë nr. *** (pra, rreth katër muaj me vonesë nga data e lidhjes së kontratës së dytë, vonesë për të cilën është paguar gjoba përkatëse) dhe në datën 28.3.2012, pasuria është regjistruar në emër të blerësit R. H..
- ix) në DPV-në për vitin 2011, subjekti ka deklaruar kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2011, duke përmendur rivlerësimin e pasurisë në dhjetor të vitit 2010 me vlerë 3.644.800 lekë.

Për sa më sipër, pavarësisht të ekzistencës së dy kontratave të shitjes, për përfundim të hetimit administrativ u vërtetua plotësisht se:

- 1) Subjekti e ka përfituar çmimin e shitjes së pasurisë nr. ***, prej 4.000.000 lekësh, me lidhjen e kontratës së parë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.10.2009, shumë të cilën e ka përdorur duke e paguar në datën 9.10.2009 për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi nr. ***, në Rr. “****”, ditë kur u lidh kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. ***.
- 2) Lidhja e kontratës së dytë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2011, është kryer për faktin se blerësi R. H. i cili e kishte marrë në dorëzim apartamentin që në vitin 2009, nuk e kishte regjistruar pasurinë në ZVRPP. Fakti që blerësi ka qenë neglizhent në kryerjen e procedurave të regjistrimit të pasurisë, vërtetohet edhe me aplikimin për regjistrimin e kontratës së dytë në

³⁰ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 14.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot.A/D, datë 20.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në dosjen e Komisionit.

³¹ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 29.9.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

datën 2.11.2011, katër muaj me vonesë pas redaktimit të saj, vonesë për të cilën ka paguar dhe gjobën përkatëse.

3) Deklarimet e subjektit përputhen plotësisht me dokumentet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit.

Si rezultat, shuma prej 4.000.000 lekësh është llogaritur si e ardhur ligjore në analizën financiare për vitin 2009, dhe rrjedhimisht, si burim krijimi i pasurisë objekt shqyrtimi, me adresë Rr. “***”.

4.4.2 Burimi të ardhurat nga pagat

Në DPV-në për vitin 2009, si burim i pasurisë është deklaruar vetëm shitja e apartamentit në Rr. “****” me nr. pasurie *** në vitin 2009, trajtuar më sipër. Ndërsa në deklaratën *Vetting*, përveç këtij burimi, janë deklaruar edhe kursimet nga pagat. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi këtë fakt, në përgjigjet e pyetësorit shtesë të datës 6.4.2020, subjekti ka deklaruar se si burim për blerjen e këtij apartamenti ka shërbyer shitja e apartamentit në Rr. “****” dhe kursimet nga paga, njësoj siç është deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Duke mbajtur në konsideratë peshën dhe epërsinë e deklaratës *Vetting* në raport me deklaratimet periodike, në kuptim të pikës 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni përfshiu gjatë analizës financiare të ardhurat nga pagat për periudhën nga 1 janar 2009 – 9 tetor 2009, të cilat subjekti i ka deklaruar saktësisht me DPV për vitin 2009.

Pas verifikimit të dokumenteve shkresore, u konstatua se: (i) të ardhurat nga pagat e subjektit për periudhën 1 janar – 9 tetor 2009, janë në shumën 866.509 lekë; (ii) të ardhurat e bashkëshortes nga pagat, janë në shumën 240.000 lekë³², ndërsa nga komisionet e shitjes pranë shoqërisë “****” sh.a., në shumën prej 194.100 lekësh dhe 5.731 euro³³.

Për sa i takon të ardhurave nga komisionet e shitjeve pranë shoqërisë “****” sh.a, megjithëse është e njohur mënyra e operimit të shpërblimit të agjentëve/punonjësve të punësuar në kompanitë e sigurimit, shpërblim i cili përbëhet nga paga bazë minimale dhe komisione në bazë të shitjes, gjatë hetimit administrativ, Komisioni nuk ka administruar një dokument zyrtar që të provojë në mënyrë specifike dhe direkte pagesën e tatimit në burim mbi këto të ardhura³⁴. Për rrjedhojë, të ardhurat e deklaruara nga subjekti për komisionet e shitjes së bashkëshortes, nuk u përfshinë si e ardhur ligjore në analizën financiare pasqyruar në tabelën më poshtë, dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

Përshkrimi	9.10.2009
PASURI	5.738.953
Blerje apartamenti Rr. “****”, blerë në vlerën 42.800 euro ³⁵	5.870.876
<i>Ndryshim Likuiditetesh</i>	-131.923
Likuiditete Gjendje	835.000
TË ARDHURA	5.106.509

³² Bazuar në levizjet e llogarisë së bashkëshortes sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.3.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

³³ Subjekti ka vënë në dispozicion vërtetim të datës 21.2.2016, nga shoqëria “****”, i cili vërteton punësimin e znj. M. D. për periudhën 1.12.2008 – 30.11.2010 dhe se gjatë kësaj periudhe ajo është shpërblyer me komisione në vlerën *neto* 194.100 lekë dhe 5.731 euro. Gjithashtu, me shkresën nr. 881 prot., datë 7.7.2020, shoqëria “Sigma InterAlbanian” informon se znj. M. D., gjatë periudhës 1.12.2008 – 30.11.2010, përveç pagës është shpërblyer me komisione mbi shitjet mujore dhe se për të gjitha komisionet është repektuar legjislacioni tatimor në fuqi.

³⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 7.7.2020 citon: “... për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, është e pamundur të vë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar në lidhje me komisionet e shitjes, për arsye të reduktimit të administratës së kompanisë”.

³⁵ Kursi i këmbimit 1 euro = 137.17 lekë, Banka e Shqipërisë 31.12.2009.

Të ardhura nga pagat e subjektit	866.509
Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	240.000
Të ardhura nga komisionet e shitjes së bashkëshortes	0
Shitja apartamentit Rr. “****”	4.000.000
SHPENZIME	502.668
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së, për katër persona	420.715
Shpenzime udhëtimi sipas TIMS	81.953
Mundësia për Kursime	-1.135.112

Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit të ndodhur në Rr. “****”, me numër pasurie 7/837/ND+1-9, për shkak të një balance negative në shumën prej -1.135.112 lekësh. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova që vërtetojnë pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale të bashkëshortes, si dhe çdo dokument tjetër shkresor, për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Në parashtrimet e tij subjekti arriti të vërtetojë të kundërtën e barrës së provës për sa i takon të ardhurave të bashkëshortes nga shoqëria “****” sh.a, duke sqaruar se, për periudhën kohore 1.1.2009 – 9.10.2009, në total të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja M. D. vetëm për bonuset dhe komisionet, kanë qënë në shumën 525.007 lekë, të cilat kanë shërbyer si burime financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në Rr. “****” në vitin 2009 dhe, prandaj, kjo shumë duhet të merret në konsideratë dhe të përfshihet në analizën financiare.

Për të vërtetuar pretendimet e tij subjekti ka vënë në dispozicion shkresën nr. *** prot., datë 27.11.2020, të shoqërisë “****” sh. a., bashkalidhur të cilës gjendet një pasqyrë analitike për pagesat e bonuseve dhe komisioneve kryer çdo muaj, për periudhën janar 2009 – nëntor 2010. Shuma e paguar në total është 263.232 lekë dhe 5.144 euro;

Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni konstatoi se subjekti ka vërtetuar me dokument shkresor pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale të bashkëshortes nga shoqëria “****” sh.a., pasi shkresa e vënë në dispozicion është konform ligjit dhe procedurave tatimore të deklarimit dhe vërteton pagesat e detyrimeve në organet tatimore. Për rrjedhojë, të ardhurat e bashkëshortes si bonuse dhe komisione shitjeje mbi pagën, në shumën 535.651 lekë³⁶ për periudhën e analizuar, janë përfshirë në analizën financiare, balanca negative e së cilës, nga -1.135.112 lekë, bëhet -599.460 lekë.

Për sa i takon balancës negative prej -599.460 lekë, subjekti, nëpërmjet analizës financiare nga një ekspert kontabël të paraqitur, pretendon se “ndryshimi i likuiditeteve”, duhet të konsiderohet bazuar në metodologjinë kumulative³⁷, sipas së cilës, rezultati financiar për të gjitha vitet e mëparshme deri më 9.10.2009, do të ishte pozitiv. Por, kjo metodologji e pretenduar, nuk mund të merret në konsideratë nga Komisioni, pasi në rast se ka pasur teprica të mbetura nga pagat e tërhequra nga banka, duke zbritur shpenzimet e kryera gjatë vitit, subjekti ka pasur detyrim ligjor t’i deklaronte si kursime në *cash* në fund të çdo viti, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, gjë që nuk e ka bërë.

³⁶ Si kurs këmbimi është përdorur 1 euro = 137.17 lekë, datë 31.12.2009, Banka e Shqipërisë.

³⁷ Sipas aktit të ekspertit, vënë në dispozicion nga subjekti, për vitin 2008, diferenca/mbetja e tërheqjeve nga llogaria e pagës së subjektit, plus paga e bashkëshortes, minus shpenzimet vjetore të llogaritura nga Komisioni, duhet të konsiderohen si kursime dhe të mbarten si tepriçë *cash* në vitin 2009. Duke aplikuar këtë qasje deri në datën 9.10.2009, analiza e subjektit rezultoi me një rezultat negativ prej -255.844 lekësh. Duke aplikuar këtë qasje edhe për vitet e mëparshme, subjekti pretendon që rezultati financiar më 9.10.2009, do të ishte pozitiv.

Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se balanca negative prej -599.460 lekësh, e rezultuar nga analiza përfundimtare financiare e kryer për të verifikuar mundësinë e blerjes së pasurisë me të ardhura të ligjshme, në proporcion me të gjitha provat e administruara gjatë këtij procesi, nuk u konsiderua si shkak për të vlerësuar që subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme, në kuptim të neni 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

5. Pronar i automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa *, ngjyrë blu, viti i prodhimit 1986 me vlerë 250.000 lekë, për të cilin, subjekti ka deklaruar se:**

*“Ky automjet është blerë në bazë të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.8.2003, me kursime ndër vite nga paga.*

*- Ky automjet nga persona ende të pidentifikuar në datën 21.5.2009, në Rrugën e Durrësit, më është vjedhur dhe për të cilën Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 21.5.2009 ka regjistruar procedimin penal nr. 1908, për veprën penale ‘vjedhje’ parashikuar nga neni 134 /1 i Kodit Penal. Me shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është kërkuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor çregjistrimi i mjetit me targa ***”.*

Pas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ, DPSHTRr-ja³⁸ informoi se subjekti: (i) ka pasur në pronësi automjetin me targa *** (me status çregjistrim i përhershëm); (ii) ka aktualisht në pronësi automjetin me targa ***, blerë pas plotësimit të deklaratës *Vetting*.

Lidhur me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie rezultoi se me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.8.2003, subjekti ka blerë automjetin tip “Daimler Benz” me targa provizore nga shitësi H. M. në vlerën 250.000 lekë, të cilin e regjistroi në emër të tij datë 20.8.2003, me targa ***. Në vitin 2016, ky automjet është çregjistruar me kërkesë të Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka rezultuar i vjedhur në vitin 2009 nga persona ende të pidentifikuar, fakt i deklaruar nga subjekti edhe në DPV-në e vitit 2009.

Ndërsa sipas kontratës, automjeti ishte blerë në çmimin 250.000 lekë, në DPV-në për vitin 2003 subjekti e ka deklaruar në vlerën 400.000 lekë, me burim të ardhurat nga paga. Subjekti, i pyetur në lidhje me këtë deklaram, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se vlera e blerjes së automjetit është 250.000 lekë, sikurse është pasqyruar në kontratën e blerjes dhe se shkak i deklaramit të vlerës prej 400.000 lekësh për vitin 2003, ka qenë përfshirja e shumës së paguar për zhdoganimin e automjetit në vlerën 151.473 lekë. Si rezultat, në analizën financiare vlera e automjetit është llogaritur në shumën 400.000 lekë dhe ashtu sikurse pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në vlerën 400.000 lekë.

Përshkrimi	9.5.2002 – 6.8.2003
PASURI	400.000
Automjet tip “Benz” ***	400.000
TË ARDHURA	911.228
Të ardhura nga pagat e subjektit	911.228
SHPENZIME	461.809
Shpenzime jetese, sipas ILDKPKI-së për 4 persona	461.809
Mundësia për kursime	49.419

Në këtë analizë janë marrë të dhëna nga blerja e apartamentit në Rr. “****” Tiranë në datën 9.5.2002 deri në blerjen e automjetit, ku janë përfshirë: (i) pagat e subjektit nga data 9.5.2002

³⁸Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 25.12.2019, nga DPSHTRr-ja në dosjen e Komisionit.

deri më 6.8.2003; (ii) shpenzimet e jetesës janë përlogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së për 4 persona, për të njëjtën periudhë.

Përveç pasurive të deklaruara dhe të analizuara më sipër, në rubrikën “të ardhura” subjekti ka deklaruar:

- llogari rrjedhëse të pagës në “Credins Bank”, datë 24.10.2016, vlerë 1.256.093 lekë, pjesa takuese 100 %, konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 13.3.2019;

- kartë krediti në lekë me nr. ***, hapur në datën 7.5.2015, në BKT, kartë e papërdorur, konfirmuar nga kjo bankë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2020, informon se subjekti i rivlerësimit ka kartë krediti me limit vlerën 200.000 lekë, datë 24.10.2016.

Veç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ u konstatua se depozita bankare në “Credins Bank”, në emër të subjektit, krijuar në vitet 2011 – 2014, është krijuar nga pakësimi i llogarisë së pagës së subjektit, konfirmuar nga kjo bankë³⁹ me burim pagat e subjektit. Pjesa takuese: 100 %.

Sipas dokumentacionit të administruar nga “Credins Bank”, subjekti i rivlerësimit, në vitet 2011 – 2014, ka krijuar depozita në lekë, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën, si vijon:

Credins Bank sh. a./vitet	2011	2012	2013	2014	2015
Depozitë 6-mujore në lekë, datë 10.11.2011	700.000				
Të ardhurat nga interesi i depozitës		35.127			
Depozitë 12-mujore në lekë, datë 12.11.2012		1.010.127			
Të ardhurat nga interesi i depozitës			58.162		
Depozitë 12-mujore në lekë, datë 12.11.2013			1.010.127		
Të ardhurat nga interesi i depozitës				34.535	
Depozitë 12-mujore në lekë, datë 12.11.2014				1.010.127	
Të ardhurat nga interesi i depozitës					9.792

Pas verifikimit të DPV-së konstatohet se subjekti ka kryer deklarime të sakta për periudhën 2011 – 2014, ndërsa në lidhje me burimin e krijimit, pas analizimit të mundësive financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për krijimin e këtyre depozitave në vitet 2011 – 2014, duket se kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e likuiditeteve, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën, si vijon:

Përshkrimi	2011	2012	2013	2014
PASURI	426.362	208.503	73.433	34.595
<i>Ndryshim Likuiditetesh</i>	426.362	208.503	73.433	34.595
Likuiditete Gjendje	989.407	1.197.911	1.271.344	1.305.939
TË ARDHURA	1.711.949	1.685.350	1.756.396	2.091.887
Të ardhura nga pagat sr	1.089.618	1.084.510	1.115.862	1.354.024
Të ardhura nga pagat bashkëshortja	622.331	565.713	582.372	675.283
Të ardhura nga interesi i depozitave		35.127	58.162	34.535
Të ardhura nga bursa e djalit				28.045
SHPENZIME	769.979	626.199	631.800	1.033.025
Shpenzime jetese	546.480	558.192	564.096	879.992
Shpenzime arredimi	42.857	42.857	42.857	42.857
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	163.194	25.150	24.847	85.176

³⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.3.2019, të “Credins Bank” sh.a., në dosjen e Komisionit.

Shpenzime rivlerësimi apartamenti	17.448			
Shpenzime shkollimi djali				25.000
Mundësia për kursime	515.608	850.647	1.051.162	1.024.267

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur/bashkëshortja, znj. M. D.

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. D., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar që nuk ka pasuri veçmas të regjistruara në emrin e saj. Ndërkohë, ka deklaruar bashkëpronësinë me subjektin mbi pasuritë: (i) apartament banimi me sip. 60 m², Rrëshen; (ii) apartament banimi me sip. 53.6 m², Rr. “****”; (iii) apartament banimi me sip. 107 m², Rr. “****”, trajtuar më sipër.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur/i biri, z. I. D.

I biri i subjektit, z. I. D., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar që nuk ka pasuri veçmas të regjistruara në emrin e tij. Ndërkohë ka deklaruar bashkëpronësinë mbi apartamentin e banimit me sip. 107 m², ndodhur në Rr. “****”, në një kohë që nuk ka qenë bashkëpronar i kësaj pasurie, trajtuar më sipër.

Konstatime të tjera

Përveç verifikimit të pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, Komisioni kreu hetime në lidhje me disa konstatime të rezultuara gjatë procesit të rivlerësimit, si vijojnë:

1) Duke marrë shkas nga informacionet e publikuara në media në [linkun https://pamfleti.net/prokurori-albert-demirneli-qe-ka-denuar-179-persona-per-falsifikim-vete-ka-falsifikuar-kohen-e-emerimit-ne-detyre-e-ca-te-tjera/](https://pamfleti.net/prokurori-albert-demirneli-qe-ka-denuar-179-persona-per-falsifikim-vete-ka-falsifikuar-kohen-e-emerimit-ne-detyre-e-ca-te-tjera/), i cili hedh dyshime mbi falsifikimin e datave të emërimit në detyrë nga subjekti, Komisioni kreu verifikime të DPV-ve, ku u konstatua se subjekti ka deklaruar si data të emërimit në detyrë dy data: 7.1.2002 dhe 1.6.2002.

Gjatë hetimit administrativ, i pyetur mbi këtë fakt, subjekti ka sqaruar⁴⁰ se me Dekretin nr. ***, datë 7.1.2002, të Presidentit të Republikës është transferuar nga Prokuroria e Rrethit Mirditë, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, ndërsa me urdhrin nr. ***, datë 30.5.2002, të Prokurorit të Përgjithshëm është caktuar zëvendësprokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku marrëdhëniet financiare në këtë detyrë i kanë nisur më 1.6.2002. Për të vërtetuar pretendimet e tij subjekti paraqiti dokumentet shkresore:

- dekret për emërim dhe transferim prokurori të datës 7.1.2002, sipas të cilit prokurori Albert Demirneli transferohet nga Prokuroria e Rrethit Mirditë në Prokurorinë e Rrethit Tiranë;
- shkresë nr. *** prot., datë 10.1.2002, “Për emërim kuadri”, të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas së cilës marrëdhëniet financiare në Prokurorinë e Rrethit Mirditë i priten më 7.1.2002 dhe i fillojnë në Prokurorinë e Rrethit Tiranë më 8.1.2002.

Nga verifikimi i vërtetimeve të pagave të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ILDKPKI⁴¹, vërtetohet emërimi dhe transferimi i subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demirneli, nga Prokuroria e Rrethit Mirditë në Prokurorinë e Rrethit Tiranë në datën 7.1.2002, fakt i cili gjen pasqyrim më konkretisht edhe në vërtetimin e Prokurorisë Tiranë, datë 14.10.2016, në të cilin pasqyrohet paga për çdo vit duke nisur nga janari i vitit 2002 deri në shtator të vitit 2016, si dhe konfirmohet fakti se: “*Albert Demirneli është me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nga janari i vitit 2002 e në vazhdim*”. Duke qenë se në këtë vërtetim nuk evidentohet pozicioni i subjektit të rivlerësimit si zv/drejtues i Prokurorisë

⁴⁰Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 3.7.2020, në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Shihni dokumentet në aneksin 4/7, të ILDKPKI-së.

Tiranë datë 30.5.2002 dhe periudha e kryerjes së kësaj detyre administrative, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit i është kërkuar të vërtetohet me dokument shkresor datën e emërimit si zv/drejtues në Prokurorinë Tiranë dhe kohën/periudhën e ushtrimit të kësaj detyre, si dhe të japë çdo sqarim në lidhje me informacionin e marrë nga mediat *online* në lidhje me periudhat e emërimeve në detyrë.

Në parashtrimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit disa dokumente shkresore nga verifikimi i të cilave rezultoi se:

Së pari, caktimi i subjektivit të rivlerësimit si zv/drejtues i Prokurorisë Tiranë më 30.5.2002, përveçse ishte vërtetuar gjatë hetimit administrativ me vërtetimet nga pagat, gjen pasqyrim edhe në shkresën nr. *** prot., datë 30.5.2002, të zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme, nëpërmjet së cilës informohet Prokuroria e Rrethit Tiranë, mbi urdhrin nr. ***, datë 30.5.2002, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe se marrëdhëniet financiare në detyrën e prokurorit i priten në datën 31.5.2002 dhe i fillojnë në detyrën e zv/prokurorit të rrethit më 1.6.2002.

Së dyti, periudhat e emërimit në detyrë të referuara nga subjekti i rivlerësimit dhe vërtetuar me dokumente shkresore, gjejnë pasqyrim edhe në vërtetimet e pagave të administruara nga Komisioni, në mënyrën e përshkruar, si vijon:

- me urdhër të kryetarit të Hetuesisë së Përgjithshme, datë 27.8.1987, subjekti është emëruar hetues pranë Hetuesisë së Rrethit Kukës, pasqyruar në vërtetimin e pagës nr. *** prot., datë 17.10.2016, i cili vërteton se subjekti ka punuar në Hetuesinë e Rrethit Kukës me detyrën e hetuesit për periudhën 1.1.1988 – 15.10.1991;

- me urdhër të kryetarit të Hetuesisë së Përgjithshme, datë 16.10.1991, subjekti është emëruar me detyrë kryetar i Hetuesisë së Rrethit Dibër, më pas hetues, pasqyruar në vërtetim page (pa datë, pa prot.) i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, i cili vërteton se subjekti ka punuar me detyrë hetues për periudhën 16.10.1991 – 27.7.1994. Ky vërtetim informon për pagat e subjektivit nga shtatori vitit 1992 deri në qershor të vitit 1994, ndërkohë që theksohet se: *“për periudhën 1.10.1991 – 1.9.1992 nuk disponojmë asnjë të dhënë”*;

- me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në datën 30.6.1994, subjekti është emëruar me detyrë prokuror i rrethit Mirditë pasqyruar në vërtetimin e pagës nr. ***, datë 20.10.2016, lëshuar nga Prokuroria e Shkallës së Parë Lezhë, i cili vërteton se subjekti ka ushtruar funksionin e prokurorit pranë ish-Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mirditë për periudhën 1.7.1994 – 15.1.2002;

- me Dekretin nr. ***, datë 7.1.2002, të Presidentit të Republikës, subjekti është transferuar si prokuror nga Prokuroria e Rrethit Mirditë në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, pasqyruar në vërtetimin e pagës datë 14.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar gjatë hetimit administrativ, i cili vërteton se subjekti është me detyrë prokuror nga janari i vitit 2002 e në vazhdim.

Bazuar në sa më sipër, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni konstatoi se subjekti ka vërtetuar me dokumente shkresore, për sa i është kërkuar, duke vërtetuar, çdo fakt dhe rrethanë në lidhje me datën e emërimit më 30.5.2002, si zv/drejtues në Prokurorinë Tiranë dhe nisjen e marrëdhënieve financiare në këtë detyrë në datën 1.6.2002.

2) Në formularin e aplikimit për kartë krediti në BKT, subjekti ka deklaruar automjetin tip “Volkswagen Passat” të vitit 2005, ndërkohë që referuar deklaratave periodike vjetore nuk rezultojnë që subjekti të ketë kryer deklarime në lidhje me këtë automjet.

I pyetur mbi shkaqet e mosdeklarimit të këtij automjeti, në përgjigjet e pyetësorit të datës 3.7.2020, subjekti ka sqaruar se: *“... në vitin 2015, me sa me kujtohet, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë kanë ardhur një grup specialistësh dhe praktikantësh të BKT-së me qëllim promovimin e produktit të kartës së kreditit, për të cilën ai ka aplikuar... kjo kartë nuk është*

përdorur kurrë nga ana e tij por është marrë për efekt targetimi të praktikantëve të kësaj banke.... gjatë asaj periudhe nuk ka pasur në pronësi asnjë lloj automjeti, por mund të jetë një gabim njerëzor nga ana e specilistëve/praktikantëve të BKT-së”.

Pasi janë kryer verifikimet e nevojshme, gjatë hetimit administrativ, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë apo informacion në lidhje me pronësinë e subjektit mbi një automjet të vitit 2005⁴².

3) Në formularin e vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në rubrikën “gjeneralitete të mëparshme”, subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, ka deklaruar mbiemrin “N.”. Ky mbiemër është deklaruar edhe në formularin e vetëdeklarimit për kontrollin e figurës në zbatim të ligjit nr. 84/2016 sipas parashikimeve të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.

Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti u pyet mbi rrethanat dhe periudhën e ndryshimit të mbiemrit, dhe në përgjigjet e pyetësorit të datës 3.7.2020 deklaroi se nuk e ka ndryshuar asnjëherë mbiemrin e tij nga Demirneli në N., duke sqaruar se në qytetin e lindjes Burrel, familja e tij para viteve ‘90, njihej me mbiemrin N. dhe se ky mbiemër është përdorur nga institucionet shtetërore, ndonëse në aktet e gjendjes civile mbiemri i tyre ka qenë gjithmonë Demirneli. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka vënë në dispozicion:

- vërtetimin nr. *** prot., datë 6.7.2020, të Bashkisë Mat, nga ku vërtetohet fakti se asnjë pjesëtar i familjes se tij nuk ka bërë ndonjë kërkesë për të ndryshuar mbiemrin nga Demirneli në N.;
- certifikatë lindje (nga akti), certifikatë personale të tij dhe të babait, si dhe certifikatën e martesës (nga akti), nga të cilat konstatohet se kanë mbajtur mbiemrin Demirneli.

Komisioni, me qëllim evidentimin e pasurive të mundshme në emër të shtetasit me gjeneralitete Albert I. N., kreu disa verifikime, duke kërkuar informacion prej ASHK-së, DPSHTRr-së, bankave dhe FSHU-së, nga përgjigjet e të cilave nuk kanë rezultuar të dhëna me këto gjeneralitete⁴³.

Analiza financiare

Gjatë hetimit administrativ është bërë një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën, si vijon:

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri neto (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime (4-3-5)
2003	2.300.000	-	2.300.000	5.545.604	2.483.707	761.897
2004	-	-200.000	200.000	1.300.529	466.874	633.655
2005	279.425	-	279.425	1.409.626	598.723	531.478
2006	304.602	-300.000	604.602	1.344.825	481.085	259.138

⁴² Shihni shkresat kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 25.12.2019 dhe nr. *** prot., datë 27.2.2019, nga DPSHTRr-ja në dosjen e Komisionit.

⁴³ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 3.7.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 7.7.2020, nga DPSHTRr-ja; shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 15.7.2020, nga FSHU-ja; shkresat kthim-përgjigje shkresës nr. *** prot., datë 3.7.2020, drejtuar bankave.

2007	419.420	-200.000	619.420	1.278.224	645.382	13.421
2008	-36.525	-	-36.525	1.105.406	755.489	386.441
2009	3.488.912	-	3.488.912	4.099.857	1.071.290	-460.346
2010	-321.913	-	-321.913	1.704.900	641.221	1.385.592
2011	426.362	-	426.362	1.711.949	769.979	515.608
2012	208.503	-	208.503	1.685.350	626.199	850.647
2013	73.433	-	73.433	1.756.396	631.800	1.051.162
2014	34.595	-	34.595	2.091.887	1.033.025	1.024.267
2015	209.813	-	209.813	2.139.447	1.072.533	857.101
2016	-313.992	-	-313.992	2.125.523	1.151.468	1.288.047
Total	7.072.636	-700.000	7.772.636	29.299.522	12.428.777	9.098.109

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare⁴⁴ të “Raiffeisen Bank”, BKT-së, “Credins Bank” dhe “Intesa Sanpaolo Bank”.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i. të ardhura nga pagat e subjektit⁴⁵, të ardhura nga pagat e bashkëshortes⁴⁶ dhe shpërblimet e bashkëshortes nga komisionet e shitjes në shoqërinë “***”⁴⁷;

ii. të ardhura nga interesat bankare⁴⁸;

iii. të ardhura nga bursa e djalit nga universiteti “***”⁴⁹.

c. Shpenzimet ku përfshihen:

i. shpenzimet e jetesës⁵⁰;

ii. shpenzimet e shkollimit⁵¹;

⁴⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 26.2.2019, e “Raiffeisen Bank”; shkresa nr. *** prot., datë 13.3.2019, e BKT-së; shkresa *** prot., datë 13.3.2019, e “Credins Bank”; shkresa nr. 19/11332/1 prot., datë 6.3.2019, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

⁴⁵ Vërtetimi nr. ***, datë 17.10.2016, nga Prokuroria Kukës për periudhën 1.1.1988 – 15.10.1991; vërtetim page nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për periudhën 16.10.1991 – 27.07.1994; vërtetim nr. ***, datë 20.10.2016, Prokuroria Lezhë për periudhën 1.7.1994 – 15.1.2002; vërtetim datë 14.10.2016, nga Prokuroria Tiranë për periudhën 2002 – 2016; vërtetim datë 8.4.2020, nga Prokuroria Tiranë për periudhën tetor - dhjetor 2016.

⁴⁶ Vërtetim nr. *** prot., nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për periudhën 1.11.2003 – 1.11.2006; vërtetim nr. *** prot., datë 16.4.2020, nga ISSh-ja për pagesë asistence për periudhën 2006 - 2007; vërtetim nr. ***, datë 12.10.16 për periudhën 1.1.2008 -31.12.2008; vërtetim, datë 21.10.2016, nga shoqëria “****” dhe shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, për periudhën 1.12.2008 – 30.10.2010; vërtetim nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga Agjencia e Akreditimit për periudhën 2010 – 2016.

⁴⁷ Vërtetim, datë 21.10.2016, nga shoqëria “****”; vërtetim nr. ***, datë 7.7.2020; vërtetim nr. *** prot., datë 27.11.2020, të shoqërisë “****” sh. a.; DPV/2009 dhe DPV/2010.

⁴⁸ Sipas lëvizjeve të llogarisë së “Credins Bank”.

⁴⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 11.10.2016, universiteti “****”; shkresa nga BKT-ja, prot. *extra* datë 11.10.2016 dhe shkresa BKT prot. *extra* datë 18.10.2016; lëvizjet e llogarisë z. I. D. për periudhën 2014 – 2017 shkresa nr. *** prot., datë 11.3.2019.

⁵⁰ Nga fillimi i detyrës dhe deri në vitin 1993 shpenzimet janë përlllogaritur në masën 80 % të ardhurave; nga viti 1994 deri në vitin 1999 janë përlllogaritur me shumën 5.000 lekë/muaj/për person. Pas vitit 2000 janë përlllogaritur shpenzimet bazuar në standardin e ILDKPKI-së – shkresa nr. *** prot., datë 29.1.2019, sipas përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit. Përbërja familjare për efekt të përlllogaritjes së shpenzimeve është ndarë në këto periudha: 1.1.1988 – 30.7.1994 për një person; 1.8.1994 –23.6.1995 kur lind djali për 2 persona; nga data e lindjes së djalit dhe deri më 13.2.2002 kur lind vajza për 3 persona; nga data e lindjes së vajzës dhe deri në fund të periudhës së rivlerësimit për 4 persona.

⁵¹ Vërtetim nr. *** prot., datë 11.10.2016, universiteti “****”; pyetësori standard përgjigjja e pyetjes 10; lëvizja e llogarisë bankare të znj. M. D. më 19.1.2016.

iii. shpenzimet e udhëtimit dhe pushimeve sipas raportit nga sistemi *TIMS* dhe sqarimet e dhëna nga subjekti në pyetësin standard. Metodologjia e përlogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit; iv. shpenzime të tjera të evidentuara nga mandatpagesa apo fatura si pagesat e tatimeve në burim në hipotekë dhe shpenzime rivlerësimi të pronës; shpenzimet e mobilimit sipas deklaramit të subjektit në pyetësin standard të ndara për vitet 2003 – 2016.

Rezultatet përfundimtare të rivlerësimit të pasurisë

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave, si vijojnë:

i. subjekti ka kryer deklarime të sakta dhe të detajuara për çdo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të përfituar si para ashtu edhe pas periudhës së rivlerësimit;

ii. në deklaratën *Vetting* janë deklaruar hollësisht dhe saktësisht edhe pasuri për të cilat subjekti nuk kishte detyrimin e deklaramit, duke lehtësuar në këtë mënyrë punën e Komisionit në evidentimin e origjinës së krimit të këtyre pasurive dhe burimeve të krijimit të tyre me të ardhura të ligjshme, me qëllim vërtetimin e ligshmërisë së përfitimit të pasurive pasardhëse;

iii. balanca negative prej - 460.346 lekësh e rezultuar në përfundim të analizës financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit 2003-2016, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, në raport me të gjitha faktet dhe rrethanat e sipërpërmendura nuk mund të konsiderohet si pamjaftueshmëri në deklarime, që do të sillte si pasojë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, e aq më pak të ketë cënuar besimin e publikut të subjektit i rivlerësimit, si pjesë e sistemit të drejtësisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 26.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Albert I. Demirneli, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 12.12.2019, të KDZh-së, nga ku rezultojnë se:

-formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;

-ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës;

-nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Albert I. Demirneli, është konsideruar i përshtatshëm për vijimin e detyrës.

Pavarësisht konstatimit të DSIK-së, Komisioni kërkoi përditësim të dhënash në lidhje me subjektin e rivlerësimit, për të cilin DSIK-ja⁵² informoi se për këtë subjekt ka kryer kërkime për përditësim informacioni, nga të cilat nuk rezultuan të dhëna.

Për sa i takon të dhënave nga hyrje-daljet në sistemin *TIMS*, gjatë procesit të rivlerësimit, i pyetur mbi pronarët e automjeteve me të cilët ka udhëtuar, marrëdhëniet me ta dhe qëllimin e udhëtimeve, z. Albert I. Demirneli ka deklaruar⁵³ se udhëtimet me këto automjete kanë qenë më së shumti për vizita turistike, duke informuar rast pas rasti për pronarët e automjeteve dhe relatat me ta.

Gjatë hetimit administrativ, për të gjithë shtetasit e deklaruar si pronarë të automjeteve me të cilët subjekti ka udhëtuar, SPAK-ut iu kërkua informacion për përfshirje të tyre në krimin e organizuar dhe në informacionin e vënë në dispozicion nuk rezultuan procedime penale të regjistruara në emër të këtyre shtetasve⁵⁴. Po kështu, nga verifikimet e kryera në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi gjatë ushtrimit të detyrës, nuk u vërtetua që subjekti të ketë pasur për shqyrtim çështje penale të këtyre shtetasve apo subjekteve⁵⁵.

Veç sa më sipër, Komisioni verifikoi në sistemin AMF automjetet e evidentuara në sistemin *TIMS* dhe deklarimet e subjektit, për sa i takon pronarëve të këtyre automjeteve, rezultuan të sakta, duke përjashtuar automjetet me targa *** dhe ***, të cilët subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në pronësi të shtetasit N. L. P., ndërkohë që, këto automjete figuronin përkatësisht në pronësi të shtetasve I. B. i datëlindjes 26.8.1969 dhe S. Sh. i datëlindjes 18.3.1982.

Nisur nga ky fakt, Komisioni thelloi hetimin administrativ duke kryer verifikime në lidhje me këta persona, si vijojnë:

Në lidhje me përfshirjen e këtyre dy shtetasve në veprimtari të krimit të organizuar, SPAK-u⁵⁶ informoi Komisionin se: (i) për shtetasin I. B. i datëlindjes 26.8.1969 nuk rezultoi i regjistruar ndonjë procedim penal; (ii) ndaj shtetasit S. R. Sh. i datëlindjes 18.3.1982, rezultoi që të jetë regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2013, për nenin 283/a/2⁵⁷-22 të Kodit Penal. Pas kryerjes së hetimeve të këtij procedimi është vendosur ndarja e procedimit në procedimin nr. ***, viti 2014 dhe në procedimin nr. ***, viti 2013. Pas përfundimit të hetimeve për procedimin penal nr. ***, të vitit 2014 është vendosur dërgimi në gjyq i këtij procedimi në ngarkim të të pandehurit S. Sh. etj., më 23.12.2014, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2-22 i Kodit Penal.

Për sa i takon automjetit me targa ***, në pronësi të shtetasit S. Sh., proceduar dhe dënuar penalisht për vepra penale të përfshira në krimin e organizuar, referuar të dhënave të sistemit *TIMS*, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me këtë automjet në datën 31.8.2013, dhe në po këtë datë, në të njëjtën orë dhe me të njëjtin automjet ka udhëtuar edhe shtetasi N. L. P.. Ndërkohë, në këtë datë, shtetasi S. Sh. nuk ka pasur hyrje-dalje jashtë shtetit.

Në lidhje me shtetasit S. Sh. dhe I. B., pronarë të automjeteve me targa *** dhe ***, me të cilat subjekti ka udhëtuar u kryen verifikime në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi gjatë

⁵² Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 23.4.2020, nga DSIK-ja në dosjen e Komisionit.

⁵³ Shihni përgjigjet e pyetësorit shtesë datë 6.4.2020, në dosjen e Komisionit.

⁵⁴ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 12.5.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁵⁵ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 14.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot. A/D, datë 20.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në dosjen e Komisionit.

⁵⁶ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 17.11.2020, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Trafikimi i narkotikëve.

ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë shqyrtuar kallëzime apo procedime penale në ngarkim të tyre⁵⁸.

Duke qenë se shtetasi S. Sh., i cili sipas të dhënave të policëmbajtësit në sistemin e AMF-së figuroi pronar i automjetit, rezultoi i proceduar penalisht për vepra të përfshira në krimin e organizuar dhe gjatë hetimit administrativ subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me marrëdhëniet me këtë shtetas, ashtu sikurse me shtetasin N. L. P., si dhe iu kërkua informacion për mënyrën e përdorimit të automjetit në momentin e udhëtimit.

Në përgjigjen e datës 20.11.2020, subjekti deklaroi: *“... ashtu sikurse kam deklaruar në pyetësorin shtesë të datës 6.4.2020, unë kam udhëtuar me mikun tim N. L. P. me automjetin me targa *** në datën 31.8.2013 me destinacion Tiranë-Podgoricë, Mali i Zi-Tiranë. Në këtë udhëtim kam qenë pasagjer dhe, për rrjedhojë, nuk kam pasur asnjë tagër qoftë përdorimi apo pronësie mbi këtë automjet. Unë, siç edhe e kam theksuar në pyetësorët e mëparshëm, në dijeninë time automjeti ka qenë në pronësi të shtetasit N. P., pasi në pikat e kalimit të kontrollit kufitar në atë periudhë nuk lejohej që drejtuesi i automjetit të kalonte pa pasur certifikatë pronësie apo akt përdorimi mbi automjetin. Unë nuk disponoj asnjë dokumentacion mbi këtë automjet pasi kurrë nuk e kam përdorur. Shtetasin N. L. P. sikurse e kam deklaruar më parë e kam mik të vjetër që prej vitit 1994. Për sa i përket shtetasit S. Sh., deklaroj me përgjegjësi të plotë ligjore dhe morale se është e hera e parë që e dëgjoj si emër dhe kurrë në jetën personale apo profesionale nuk e kam takuar, nuk kam komunikuar dhe s’kam pasur as edhe një lloj kontakti me këtë shtetas. Kjo gjë është lehtësisht e verifikueshme nga ana juaj”.*

Për sa më sipër, subjekti ka pretenduar se në dijeninë e tij automjeti ka qenë në pronësi të shtetasit N. L. P. dhe se nuk ka pasur asnjë njohje me shtetasin S. Sh.. Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore pronësinë e shtetasit S. Sh. mbi automjetin me targa *** në datën e udhëtimit 31.8.2013, si dhe faktin e lejimit të përdorimit të këtij automjeti nga shtetasi N. L. P., në këtë datë.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur dokumentet shkresore, si vijojnë:

-prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.12.2013, sipas së cilës i përfaqësuar S. Sh., i datëlindjes 18.3.1982, pronar i automjetit tip “Audi”, me nr. shasie *** , me targa *** , ka emëruar përfaqësues të posaçëm avokatin N. P., të cilit midis shumë të drejtave në lidhje me automjetin i ka dhënë të drejtën që ta përdorë, duke qarkulluar në të gjithë terrirotin e Shqipërisë dhe jashtë saj, si dhe të drejtën ta japë automjetin në përdorim, me qira apo t’ia shesë atë kujtdo dhe kundrejt çmimit që do ta shohë të arsyeshme;

-certifikatë e pronësisë së automjetit me targa *** dhe nr. shasie *** , në emër të shtetasit S. Sh., lëshuar më 21.6.2013, nga Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor Berat;

-leje qarkullimi nr. *** për automjetin me targa *** , në emër të z. S. Sh..

Siç vërehet, subjekti vërtetoi që automjeti me targa *** ka qenë në pronësi të shtetasit S. Sh., i cili në datën 16.12.2013 ka autorizuar shtetasin N. L. P. për përdorimin e tij, ndërkohë që, udhëtimi me këtë shtetas dhe me këtë automjet ka qenë në datën 31.8.2013. Po kështu, nga të dhënat e sistemit TIMS rezultoi që ky shtetas ka përdorur në disa raste këtë automjet për udhëtime jashtë shtetit. I pyetur gjatë seancës dëgjimore mbi dijeninë e tij në lidhje me përdorimin e automjetit në datën 31.8.2013, nga shtetasi N. L. P. pa pasur një dokument që lejonte përdorimin e automjetit, subjekti deklaroi se nuk kishte asnjë dijeni në lidhje me këtë,

⁵⁸ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 28.9.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 13.10.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në dosjen e Komisionit.

duke këmbëngulur në faktin se udhëtimi kishte qenë një vizitë njëditore dhe se shtetasin Saimir Shosha nuk e njihnte dhe nuk e kishte takuar kurrë.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, pavarësisht se në ditën e udhëtimit, datë 31.3.2013, nuk rezulton që shtetasi N. L. P. të ketë qenë i pajisur me një prokurë apo autorizim për përdorimin e automjetit me targa *** nga pronari i automjetit, shtetasi S. Sh., Komisioni nuk evidentoi asnjë nga rrethanat e parashikuara nga pika 4, e nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjekteve me një person të përfshirë në krimin e organizuar, referuar fakteve si vijojnë:

- i. në datën 31.8.2013, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me automjetin në pronësi të shtetasit S. Sh., por jo me këtë shtetas;
- ii. shtetasi N. L. P. me të cilin subjekti ka udhëtuar në datën 31.8.2013 është pajisur me një prokurë të datës 16.12.2013, nëpërmjet së cilës pronari i tij, z. S. Sh., i ka dhënë të drejta të plota mbi automjetin. Ndërkohë, nga të dhënat e sistemit *TIMS*, shtetasi N. L. P. është vërtetuar të ketë pasur disa udhëtime jashtë shtetit me këtë automjet. Këto fakte hedhin dritë mbi pretendimin e subjektit se në dijeninë e tij, automjeti ka qenë në pronësi të shtetasit N. L. P.;
- iii. nga të dhënat e sistemit *TIMS* u vërtetua që shtetasi Saimir Shosha nuk ka pasur hyrje-dalje jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë në datën 31.8.2013;
- iv. nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim i ligjshëm në lidhje me kontakte të mundshme të subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas.

3. Duke marrë shkas nga informacionet e publikuara në media në linkun <https://translate.google.com/translate?hl=en&sl=sq&u=https://www.faxweb.al/videoekskluzive-takimi-i-dyshimte-ne-lokal-prokuroret-qe-hetojne-vrasjen-e-santiago-malkos-miqesi-me-avokatet-e-autoreve/&prev=search>, në të cilat pretendohet se subjekti Albert Demireli dhe prokurori tjetër i çështjes z. N. T., të cilët hetojnë vrasjen e shtetasit S. M., janë fotografuar në një takim me avokatët e autorëve të ngjarjes, mes tyre avokati i shtetasit B. T., z. I. M., dy javë pas vrasjes së 26 vjeçarit S. M., Komisioni kreu një sërë verifikimesh. Konkretisht:

Subjekti, i pyetur mbi rrethanat dhe qëllimin e këtij takimi, deklaroi⁵⁹ se është në dijeni të këtij shkrimi duke sqaruar se: “... ditën që bëhet fjalë rreth orës 16:20, pas mbarimit të punës, së bashku me kolegun tim prokuror N. T., kemi dalë nga institucioni për të vajtur në shtëpi, ku rastësisht jam takuar me shokun tim të fakultetit K. S., aktualisht me profesion avokat, i cili na ftoi për të pirë diçka dhe u ulëm në një bar, i cili ndodhet në krah të godinës së prokurorisë. Me sa më kujtohet, më pas kanë ardhur edhe avokatët I. M. dhe L. B. duke u ulur në tavolinën tonë. Nga ana ime nuk kam pasur dijeni se ndonjëri nga avokatët me të cilët ne jemi ulur në tavolinë të kenë qenë përfaqësues ligjorë të të arrestuarit B. T.. Pretendimet e ngritura në këtë shkrim janë tërësisht të pavërteta, pasi asnjëri prej këtyre avokatëve nuk rezulton të ketë qenë mbrojtës ligjor në çështjen penale në ngarkim të të arrestuarit shtetasit B. T. ... ”.

Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti paraqiti:

-vërtetim nr. *** prot., datë 2.10.2019, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë të prokurorit N.T., sipas të cilit vërtetohet se në seancën gjyqësore të datës 16.9.2019, lidhur me kërkesën për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit regjistruar me nr. 2136 akti, personi nën hetim B. J. T. është mbrojtur nga av. L. Th. dhe av. B. S. sipas prokurave përkatëse;

-vendim nr. *** regj. Them., datë 16.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal”, sipas të cilit, ndaj personit

⁵⁹ Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 3.7.2020, në dosjen e Komisionit.

nën hetim B.T., është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Pas kërkesës së Komisionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁰ informoi se në seancën e vlerësimit të ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit, personi nën hetim B. J. T. është mbrojtur nga av. L.Th. dhe av. B. S. Ndërsa ndaj personave të tjerë të dyshuar, kjo gjykatë, në dhomë këshillimi dhe pa praninë e palëve, ka vendosur “arrest në burg” në mungesë, ndërkohë që aktet e kësaj çështjeje penale i janë përcjellë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Në analizë të informacionit të mësipërm, në përfundim të hetimit administrativ nuk u vërtetuan pretendimet e ngritura në shkrimin e publikuar në media lidhur me takimin e prokurorit Albert Demirneli me avokatët e çështjes.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demirneli, bazuar në:

C/1 Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, protokolluar nga Komisioni me nr. * prot., datë 8.9.2020, nga ku rezultuan gjetjet, si më poshtë.**

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Albert Demirneli, tregon korrektësi në zbatimin e ligjit. Në tre aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme, pothuajse në të gjitha rastet. Në shumicën e rasteve, analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe urdhrit nr. ***, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore” (dosja 4 dhe dosja 5). Aktet e përpiluara prej tij janë administruar në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrit.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore ka respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe (me përjashtim të germave *ë* dhe *ç*) në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej tij. Aktet e përpiluara janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje dhe formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Rezulton se konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf. Subjekti i rivlerësimit ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit, parashikuar nga neni 47 i Kodit Penal (dokumenti 1, dosja 4, dhe dosja 5). Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

⁶⁰ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 28.9.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në dosjen e Komisionit.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Prokurori Albert Demirneli, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 1163 çështje materiale. Kjo dokumentohet me tabelat statistikore të vëna në dispozicion nga Zyra e Regjistrimit, 30 fletë gjithsej, si dhe me vërtetimin nr. *** prot., datë 16.7.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore. Prokurori ka kryer detyrat e tij në pajtim me pikën 2 dhe 2. 1 të urdhrit nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, që përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë.

Subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, ka ushtruar ndjekje penale në një sërë materialesh hetimore. Në referencë të të dhënave statistikore dhe obligimeve të tij ligjore, konstatohet se prokurori ka përballuar ngarkesë pune mjaft të lartë gjatë periudhës së rivlerësimit.

Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij ka qenë në përgjithësi brenda afateve sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për mospërgatitjen e tij për çështjen në gjykim.

Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe KEDNJ-së, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Referuar të dhënave statistikore për punën e kryer, rezulton se prokurori ka përballuar me efikasitet një ngarkesë të lartë pune. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Albert Demirneli, është eficient dhe efektiv. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Albert Demirneli, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim. Nga vlerësimet e punës së subjektit të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për vitet 2014, 2015 dhe 2016, subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë organizative të treguara prej tij sipas treguesve vjetorë të punës.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e gjykatës.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e rivlerësimit, tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Albert Demirneli, nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Nga vlerësimet e punës së subjektit, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për vitet 2014, 2015 dhe 2016, subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale të treguar prej tij.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e subjektit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Nga vlerësimet e punës së subjektit të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për vitet 2014, 2015 dhe 2016, subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nga vlerësimet e punës së subjektit të kryera nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për vitet 2014, 2015 dhe 2016, subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit të treguara prej tij, në raport me institucionet e tjera ligjzbatuese, publikun dhe personat e tretë.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Albert Demirneli, i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai deklaroi se është angazhuar në 2 aktivitete profesionale (seminare). Nuk janë dorëzuar dokumente të tjera, që vërtetojnë pjesëmarrjen në trajnime të tjera të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës jashtë periudhës së rivlerësimit apo në trajnime të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

C/ 2 Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

1. Informacioni i marrë nga tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave prej Komisionit, rezultuan gjetje të konstatuara edhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në raportin e tij.

Gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, gjatë verifikimit të akteve të dosjes nr. 1 që i përket dokumentit ligjor vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 29.2.2016, mbi kallëzimin penal nr. *** dhe nr. ***, datë 11.9.2015, për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, u konstatua se vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë pesë muaj jashtë afatit 30-ditor i parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale “i ndryshuar”, i Prokurorit të Përgjithshëm.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime lidhur me këtë konstatim, i cili në parashtrimet e tij ka pranuar tejkalimin e afatit 30-ditor, duke sqaruar se kjo ka ndodhur për shkak të ngarkesës së lartë në punë, por në thelb nuk ka cënuar zgjidhjen ligjore të çështjes dhe askujt nuk i janë mohuar të drejtat dhe garancitë procedurale. Sipas tij, zgjidhja ligjore ka qenë e drejtë dhe në përputhje me ligjin, prandaj dhe tejkalimi i afatit 30-ditor nuk ka sjellë asnjë pasojë. Pavarësisht këtyre pretendimeve, Komisioni vlerëson se z. Albert Demirneli në cilësinë e prokurorit, duhet të kishte marrë masa për marrjen e vendimit brenda afatit të parashikuar nga ligji. Por, duke qenë se gjatë rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit nuk janë konstatuar raste të tjera të përsëritura të tejkalimit të afateve procedurale dhe në konsideratë të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: “*Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale*”, trupi gjykues çmoi se tejkalimi i afatit 30-ditor për hetimin e çështjes në fjalë deri në marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, nuk cënon aftësitë profesionale të subjektit.

2. Informacioni i marrë nga 7 denoncime të paraqitura nga publiku, të administruara pranë Komisionit, nga të cilat 5 prej tyre përmbushin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, analizuar si vijon:

2.1 Denoncim nga shtetasja M. A.⁶¹

Në denoncimin e saj kjo shtetase pretendon se prokurori Albert Demirneli nuk ka kryer hetime lidhur me studion grafike që ka kryer ekspertimin grafik të firmave të falsifikuara të z. A. K., por ka lejuar në kundërshtim me ligjin që personi i kallëzuar prej saj të bëjë ekspertizën grafike privatisht te nipi i tij, z. V. H.

Nga aktet e paraqitura nga denoncuesja bashkëngjitur denoncimit rezultoi se me vendimin për pezullimin e procedimit penal, të datës 17.10.2018, prokurori Albert Demirneli, ka vendosur: (1) pezullimin e hetimeve paraprake të procedimit penal nr. ***, datë 18.7.2016, që bën fjalë për veprën penale “falsifikim i dokumenteve; (2) komunikimin e vendimit shtetases M. A., e cila ka të drejtën e ankimit; (3) dërgimin e akteve Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë. Ky vendim është ankimuar nga shtetasja M. A. (denoncuesja), e cila ka kërkuar prishjen e vendimit të datës 17.10.2018 të prokurorit Albert Demirneli. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 26.12.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë « Për pezullimin e procedimit penal nr. ***, datë 18.7.2016”.

⁶¹ Shihni denoncimin nga znj. M. A., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 13.3.2019, në dosjen e Komisionit.

Gjatë hetimit administrativ, pas kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶² informoi se procedimi penal nr. *** i vitit 2016 është pezulluar në datën 17.10.2018 për moszbulim të autorit të veprës penale dhe dosja është dërguar për hetime të mëtejshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Megjithatë, referuar akteve bashkëngjitur denoncimit të shtetasës M. A., në përfundim të hetimit administrativ nga Komisioni u konstatua se:

- Pretendimi i denoncueses për moskryerje hetimesh nga ana e prokurorit Albert Demirneli, nuk qëndron, pasi nga përmbajtja e vendimit të datës 17.20.3028 për pezullimin e procedimit penal nr. ***, datë 18.7.2016 të prokurorit Albert Demirneli, rezulton se në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë, organi procedues ka vendosur kryerjen e ekspertimit grafik të shkrimit dhe nënshkrimit për të përcaktuar nëse shkrimet dhe nënshkrimet e shtetasve M. A. etj., në statutin e shoqërisë “****” sh.p.k. është shkrimi dhe nënshkrimi i tyre. Për këtë qëllim është caktuar eksperti kriminalist V. H., i cili në përfundim të ekspertimit ka arritur në konkluzionin se shkrimet dhe nënshkrimet në emër të shtetasve M. A. etj., të shkruara në faqet e dokumentit objekt ekspertimi “statuti” i shoqërisë “****” sh.p.k., janë produkte të imitimeve grafike dhe nuk janë nënshkruar nga këta shtetas, por nuk mund të përcaktohet nëse ato janë shkruar ose jo nga shtetasi A. K.

- Për sa pretendohet nga denoncuesja se prokurori ka lejuar në kundërshtim me ligjin që personi i kallëzuar prej saj të bëjë ekspertizën grafike privatisht te nipit i tij V. H., denoncuesja nuk ka paraqitur asnjë provë që vërteton pretendimin e saj.

2.2 Denoncim nga shtetasi A. H.⁶³

Në denoncimin e tij ky shtetas denoncon prokurorin Albert Demirneli për shpërdorim detyre. Ai ngre dyshime se prokurori Albert Demirneli e ka marrë dosjen e tij qëllimisht për të vendosur pushimin e çështjes, pasi fillimisht çështja e tij ishte te prokurorja E. K. Ai pretendon se nuk është thirrur asnjëherë nga ky prokuror dhe se vendimin e ka nisur në adresë të gabuar (në Burrel) ndërkohë që kishte depozituar adresën e saktë te prokurorja E. K. (si banues në Tiranë), me qëllimin që vendimi të mos ankimohej.

Nga aktet e paraqitura bashkëngjitur denoncimit rezultoi se, me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shtetasit A. H. i është dërguar vendimi i mosfillimit të procedimit penal të datës 30.12.2016, i prokurorit Albert Demirneli, në fshatin ***, Mat.

Nga analiza e denoncimit të shtetasit A. H., u konstatua se:

i. për sa pretendohet nga denoncuesi mbi vendimmarrje të qëllimshme të subjektit të rivlerësimit, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes;

ii. për sa pretendohet nga denoncuesi se vendimi i mosfillimit i është dërguar nga prokurori në adresën Mat, me qëllim që ai të mos e ankimonte, referuar shkresës nr. *** prot., datë 23.1.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton i vërtetë fakti se vendimi i mosfillimit i është dërguar denoncuesit në adresën në fshatin ***, Mat.

⁶²Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 1.7.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁶³ Shihni denoncimim nga shtetasi A.H. protokolluar në Komisioni me nr. *** prot., datë 22.6.2018 në dosjen e Komisionit.

Në lidhje me këtë pretendim, gjatë hetimit administrativ, pas kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁴ vuri në dispozicion dosjen e kallëzimit të mosfilluar nr. ***, të vitit 2016. Nga verifikimi i akteve në dosje, konkretisht, referuar procesverbalit “mbi deklarinimin nga personat që kanë dijeni për veprën penale”, të datës 6.10.2016, konstatohet se shtetasi A. H. ka deklaruar vendlindjen në ***, Mat dhe banues në Tiranë, pa u specifikuar një adresë konkrete. Në dosje nuk ka akte të tjera që vërtetojnë adresën e vendbanimit të këtij shtetasi.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkua të japë sqarime mbi pretendimet e denoncuesit në lidhje me adresën e dërgimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, i cili në parashtrimet e tij sqaroi se në bazë të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, kallëzuesit i është dërguar vendimi i mosfillimit në vendbanimin e deklaruar prej tij në procesverbalin e kallëzimit penal. Sipas tij, kjo ka qenë edhe adresa e vetme e deklaruar prej tij dhe, për rrjedhojë, njoftimi i vendimit për mosfillimin e procedimit penal është dërguar për njoftim në këtë adresë. Më tej, ai ka sqaruar se referuar paragrafit 2, të nenit 291, afati i ankimit 10-ditor fillon nga data që kallëzuesi merr dijeni, dhe, sipas subjektivit rezultoi se kallëzuesi A. H., ka marrë dijeni në lidhje me vendimin e marrë nga Prokuroria duke pasur të drejtën ligjore të ushtrimit të ankimit ndaj këtij vendimi.

Gjithashtu, i pyetur gjatë seancës dëgjimore nëse ndaj vendimit për mosfillimin e procedimit penal për këtë çështje, ishte ushtruar ankim ose jo, subjekti deklaroi se ndaj vendimit ishte ushtruar ankim dhe se gjykata kishte lënë në fuqi vendimin e tij.

Nga analiza e akteve të dosjes penale dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në përfundim të procesit të rivlerësimit, nuk u konstatuan shkelje procedurale të subjektivit të rivlerësimit, pasi në dosje nuk rezultoi ndonjë adresë tjetër e deklaruar nga denoncuesi përveç adresës në *** Mat, ku dhe është dërguar vendimi për mosfillimin e procedimit penal.

2.3 Denoncim nga shtetasi M. R.⁶⁵

Në denoncimet e tij ky shtetas denoncon disa prokurorë, gjyqtarë e oficerë të policisë gjyqësore, ndër të cilët edhe prokurorin Albert Demirneli. Në lidhje me subjektivin e rivlerësimit, z. Albert Demirneli, ai pretendon se ky prokuror e ka dënuar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, ndërkohë që sipas denoncuesit ka kryer veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”. Shtetasi pretendon gjithashtu se urdhri i ekzekutimit i lëshuar nga ky prokuror është i paligjshëm pasi: (i) referimi i tij në nenet 462-467 të Kodit të Procedurës Penale është i gabuar sepse në asnjë prej këtyre neneve nuk gjendet një dispozitë që i jep të drejtë ose e detyron prokurorin të urdhërojë ekzekutimin e shkurtimit të vendimit penal; (ii) referimi i tij në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, është i gabuar, pasi shkurtimi i vendimit është bërë i ekzekutueshëm vetëm me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018 (hyrë në fuqi në datën 21.12.2018), ndërkohë që urdhri i ekzekutimit të vendimit të prokurorit Albert Demirneli i përket datës 18.12.2018, pra, përpara hyrjes në fuqi të ligjit.

Nga aktet e paraqitura nga denoncuesi, bashkëngjitur denoncimit, rezultoi se me urdhrin e ekzekutimit të vendimit të datës 18.12.2018, të prokurorit Albert Demirneli, urdhërohet ekzekutimi i shkurtimit të vendimit penal të datës 18.12.2018 të Gjykatës Tiranë. Në këtë urdhrë referohet se më 18.12.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit M. R. (denoncuesi) për veprën penale “plagosja e lehtë me dashje” dhe dënimin

⁶⁴ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 1.7.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁶⁵ Shihni denoncimin nga z. M. R., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 25.3.2019 dhe denoncimin protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 11.7.2019 në dosjen e Komisionit.

e tij me 6 muaj burgim, por në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurin në provë për 2 muaj.

Për sa i takon pretendimit të denoncuesit se nga prokurori është proceduar dhe është dërguar për gjykim për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” (për të cilën është dënuar më pas edhe nga gjykata), ndërkohë që, sipas tij, ai ka kryer veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektesinë e vendimit dhe themelit të çështjes.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se urdhri i ekzekutimit i lëshuar nga prokurori Albert Demirneli është i pabazuar në ligj, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkuan sqarime, duke i kërkuar të paraqesë edhe raste nga praktika e punës në prokurori mbi ekzekutimin e shkurtimit të vendimeve penale.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se në nenin 463 që parashikon “veprimet e prokurorit”, thuhet shprehimisht : “*Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit*”. Sipas tij, në urdhrin e ekzekutimit në fjalë, përveç neneve 462-467 të Kodit të Procedurës Penale, është përmenduar edhe neni 59 i Kodit Penal. Në vështrim të pikës 4 të këtij neni, të ndryshuar me ligjin nr. 36, datë 30.3.2017, thuhet shprehimisht: “*Afati i provës fillon nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit të Gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim*”. Në këto kushte, nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit është tërësisht i bazuar në ligjin procedural dhe material penal.

Më tej, subjekti ka sqaruar se në lëshimin e urdhrin të ekzekutimit objekt analize, ndër të tjera, i është referuar edhe ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, si një ligj i posaçëm i cili rregullon fazën procedurale të ekzekutimit të vendimeve penale nëpërmjet urdhrin të ekzekutimit që nxjerr prokurori. Sipas tij, pretendimi se vendimi i është bërë i ekzekutueshëm vetëm me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018, nuk qëndron, pasi ligji nr. 80/2018, datë 15.11.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 5.12.2018 dhe, për rrjedhojë, ky ligj ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, pra, më 21.12.2018, sikundër e ka pranuar ankuesi, ndërkohë që urdhri i ekzekutimit mban datën 18.12.2018, kështu që nuk mund t’i referohet një ligji që ende nuk kishte hyrë në fuqi.

Përveç sa më sipër, subjekti ka sqaruar se argumentet e tij gjejnë konfirmim edhe në praktikën e konsoliduar tashmë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me ekzekutimin e shkurtimit të vendimeve penale të dënimit me kusht, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, të cilat vihen në ekzekutim të nesërmen e shpalljes së vendimit. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur disa urdhra për ekzekutimin e vendimeve penale, si vijon:

- urdhër për ekzekutimin e vendimit penal nr. *** regjistri themeltar, datë 17.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- urdhër për ekzekutimin e vendimit penal nr. *** regjistri themeltar, datë 29.10.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- urdhër për ekzekutimin e vendimit penal nr. *** regjistri themeltar, datë 10.6.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- urdhër për ekzekutimin e vendimit penal nr. *** akti, datë 21.9.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- urdhër për ekzekutimin e vendimit penal nr. *** regjistri themeltar, datë 4.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga analiza e parashtrimeve të subjektit, vlerësohet se argumentat e paraqitura nga subjekti janë bindëse dhe të mbështetura në ligj. Përveç kësaj, subjekti ka paraqitur disa urdhra për ekzekutimin e vendimeve penale, të cilat dëshmojnë mbi një praktikë të konsoliduar të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me ekzekutimin e shkurtimit të vendimeve penale.

2.4 Denoncim nga shtetasi K. M.⁶⁶

Në denoncimin e tij, ky shtetas denoncon prokurorin Albert Demirneli për fshehje të pasurisë në emër të disa shtetasve të afërm të tij, korrupsion apo kontakte të papërshtatshme të tij, etj., por pa paraqitur asnjë provë a dokument shkresor për të vërtetuar pretendimet e tij.

Duke qenë se pretendimet e denoncuesit ishin në nivel deklarativ dhe nisur nga fakti që ky denoncues kishte vënë në dispozicion një numër telefoni, me qëllim mundësimin e pyetjes së tij në cilësinë e dëshmitarit, Komisioni kontaktoi me këtë numër, por rezultoi të ishte jashtë shërbimit. Megjithatë, Komisioni kreu disa verifikime në lidhje me disa persona të përmendur në denoncim, si vijojnë:

- Për shtetasin K. D., vjehri i subjektit të rivlerësimit, për të cilin denoncuesi aludonte për pasuri të subjektit të fshehura në emrin e tij, pas verifikimeve, rezultoi se në emrin këtij shtetasi figuron i regjistruar vetëm një apartament banimi me sip. 61 m²⁶⁷, Rr. “****” Tiranë. Ndërkohë, gjatë procesit, nuk rezultoi asnjë lidhje interesi midis subjektit dhe vjehrit të tij, K. D. Po kështu, për këtë shtetas SPAK-u⁶⁸ konfirmoi se nuk ka informacion mbi përfshirjen e tij në veprimtari të krimit të organizuar.

- SPAK-ut iu kërkua informacion në lidhje me shtetasin E. D., i përmendur nga denoncuesi si kunati i subjektit dhe nga informacioni nuk rezultoi që ky shtetas të jetë i përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar⁶⁹.

- SPAK-ut iu kërkua informacion në lidhje me shtetasin F. D. i datëlindjes 29.10.1975, për të cilin subjekti konfirmoi se e ka djalin e xhaxhait dhe nga informacioni nuk rezultoi që ky shtetas të jetë i përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar.⁷⁰

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni nuk gjeti në denoncimin e shtetasit K. M. ndonjë të dhënë ose provë të çdolloji, që të thellonte më tej hetimin administrativ.

2.5 Denoncime nga shtetasi A. H.⁷¹

Në denoncimet e tij, shtetasi A. H. denoncon prokurorin Albert Demirneli se nuk ka ndjekur penalisht tre personat përgjegjës për të cilët denoncuesi kishte bërë kallëzim, por ka vendosur të ndiqet penalisht vetëm njëri prej tyre, ndërkohë që të tre ishin bashkautorë. Sipas tij, prokurori nuk ka marrë parasysh fakte dhe prova konkrete lidhur me rastin, pasi ka lehtësuar autorët e veprës penale duke e cilësuar si “plagosje e lehtë me dashje”. Gjithashtu, sipas denoncuesit, subjekti nuk ka sekuestruar kamerat e dy lokaleve ku ka qenë duke kaluar me një nga personat e kallëzuar, si dhe ka treguar njëanshmëri të theksuar pasi i ka kërkuar atij të heqë dorë duke i thënë që ndiqej penalisht.

⁶⁶ Shihni denoncimin nga shtetasi K. M., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 11.3.2018, në dosjen e Komisionit.

⁶⁷ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 5.3.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁶⁸ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 17.11.2020, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

⁶⁹ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 12.5.2020, nga SPAK, në dosjen e Komisionit.

⁷⁰ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 17.11.2020, nga SPAK, në dosjen e Komisionit.

⁷¹ Shihni denoncimin nga shtetasi A. H., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 20.11.2018 dhe denoncim protokolluar nga Komisioni nr. *** prot., datë 8.1.2019 në dosjen e Komisionit.

Nga aktet bashkëngjitur denoncimit, rezultoi se sipas procesverbalit për kallëzimin e veprës penale datë 6.7.2018, shtetasi A. H. (denoncuesi) ka deklaruar se është goditur nga shtetasi K. Y. dhe E. Y. (H. B.). Gjithashtu, në informacionin për referimin e veprës penale te prokurori të datës 11.7.2018, nga OPGj E. Z., referohet se materialet do t'i kalojnë Prokurorisë për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje e kryer në bashkëpunim” dhe “vetëgjyqësi” në ngarkim të shtetasve K. Y. dhe H. B. (E. Y.). Ndërsa, me urdhrin e datës 1.8.2018, prokurori Albert Demirneli ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, pa emra personash.

Pas analizës së denoncimit të shtetasit A. H. dhe dokumenteve të paraqitura, nga Komisioni u konstatua se:

- Për sa pretendohet nga denoncuesi se prokurori Albert Demirneli nuk ka ndjekur penalisht tre personat përgjegjës për të cilët ai kishte bërë kallëzim, por ka vendosur të ndiqet penalisht vetëm njëri prej tyre, ndërkohë që të tre ishin bashkautorë, nuk qëndron, pasi referuar procesverbalit për kallëzimin e veprës penale datë 6.7.2018, rezulton se shtetasi A. H. ka kallëzuar dy shtetas K. Y. dhe E. Y. (H. B.) dhe jo tre shtetas siç denoncuesi pretendon.

Po kështu, gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti i pyetur mbi këtë pretendim sqaroi⁷² se sipas tij organi procedues ka kryer hetime të plota dhe objektive në kuadër të procedimit penal nr. ***, regjistruar më 1.8.2018 dhe në përfundim të hetimeve në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën 22.1.2019, ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të procedimit penal nr. *** në ngarkim të të pandehurve H. B. dhe K. Y., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 – 25 të Kodit Penal, në dëm të viktimës së veprës penale, A. H. Me kërkesë të tij, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor i ka vënë në dispozicion⁷³ dosjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2019, dosje te cilën subjekti ia paraqiti Komisionit.

- Në lidhje me pretendimin e denoncuesit, se ai ka marrë në dorëzim aktin e njoftimit të përfundimit të hetimeve pa datë dhe të panënshkruar nga prokurori, nuk qëndron, pasi nga verifikimi, në dosjen penale gjendet vendimi i datës 17.1.2019 për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, i nënshkruar nga prokurori, si dhe njoftimi për përfundimin e hetimeve të datës 17.1.2019, i nënshkruar gjithashtu nga prokurori dhe shtetasi Altin Hoxha. Aktet në dosjen penale janë të nënshkruara rregullisht sipas rastit nga prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore.

- Për sa pretendohet nga denoncuesi se prokurori nuk ka marrë parasysh fakte dhe prova konkrete lidhur me rastin, duke mos sekuestruar kamerat e dy lokaleve ku ai ka qenë duke kaluar me një nga personat e kallëzuar, si dhe vendin ku ndodhi ngjarja, nga verifikimi i akteve në dosjen penale, konstatohet se nuk qëndron, pasi në dosje gjenden disa urdhra për delegimin e veprimeve hetimore, përkatësisht të datave 25.11.2018 dhe 7.1.2019, ku prokurori, ndër të tjera, ka kërkuar edhe sekuestrimin e kamerave të sigurisë pranë objektit dhe ato të objektit.

- Për sa pretendohet nga denoncuesi se prokurori ka treguar njëanshmëri të theksuar pasi i ka kërkuar të heqë dorë duke i thënë që ndiqesh penalisht, nga provat e vëna në dispozicion nga denoncuesi nuk provohet një veprim i tillë i prokurorit. Gjithashtu, referuar urdhrin të prokurorit datë 1.8.2020, për delegimin e veprimeve hetimore, subjekti ka urdhëruar kryerjen e veprimit hetimor të pyetjes së viktimës nëse dëshiron që çështja të ndiqet ligjërisht, në përputhje të plotë me nenin 284/1 të Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit, “Për veprat penale të parashikuara

⁷² Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 13.5.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 20.5.2020, nga subjekti në dosjen e Komisionit.

⁷³ Shihni aktet e procedimit penal nr. ***, të vitit 2019, bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 15.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

nga nenet 84, 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 148, 149, 243, 254, 264, 275, 290 paragrafi i parë dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e viktimës, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit”.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni nuk i gjeti të bazuara pretendimet e denoncuesit dhe nuk konstatoi veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit që çenojnë aftësitë profesionale të subjektit, në të gjithë komponentët, apo dhe besimin e publikut.

3. Informacioni i marrë nga të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime, nga ku për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar se:

-Nuk ka pasur masa disiplinore. Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cënimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.

-Ndaj subjektit të rivlerësimit ka dy materiale hetimore të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si vijojnë:

a. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka informuar se: “Nuk rezulton që në emër të shtetasit Albert Demirneli të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Emri i shtetasit Albert Demirneli përmendet në kallëzimin nr. ***, viti 2019, për të cilin Gjykata e Apelit, (KR) me vendimin nr. ***, datë 14.6.2019, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 15.7. 2019. Ky procedim penal është në fazën e hetimit”.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime mbi ecurinë e këtij procedimi penal, me qëllim evidentimin e faktit nëse për subjektin ka nisur ndonjë hetim penal dhe në parashtrimet e tij, z. Albert Demirneli, ka vënë në dispozicion shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 23.11.2020, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, sipas së cilës, ndaj subjektit të rivlerësimit Albert Demirneli nuk ka nisur asnjë hetim.

b. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjqësor Durrës ka informuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar materiali kallëzues nr. *** i vitit 2019. Me vendimin datë 18.4.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjqësor Durrës është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal”.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Demirneli, referuar burimeve arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme rezultuan 5 ankesa të trajtuara nga seksionet përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme, nga verifikimi i të cilave nuk u konstatuan *indicie* për hetime të mëtejshme.

C/3 Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se:

- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 ;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

III. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 7.12.2020, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demirneli, gjatë së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues i Komisionit, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, vlerësoi se procesi i vendimmarrjes në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demirneli, duhet të bazohet në vlerësimin tërësor të tri kriterëve, referuar pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të seancës dëgjimore, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë dhe, pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Demirneli, dhe shpall këtë vendim sot, në datën 22.11.2019, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë seancës dëgjimore, ku subjekti ishte prezent, pa praninë e ndonjë përfaqësuesi ligjor.

Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar, duke paraqitur në çdo rast dokumente shkresore për të vërtetuar për sa i është kërkuar nga Komisioni, si dhe dokumente me të cilat ka vërtetuar përpjekjet e tij për grumbullim informacioni, një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë kërkuar dhe siguruar gjatë periudhës së pandemisë për shkak të COVID-19, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Albert Demirneli, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demireli, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.12.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Firdes SHULI
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka